

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit
Master Profesional në “Shkenca Penale”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Migena Leskoviku
Prof.Asoc.Dr. Alketa Elezi



Prill 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

Master Profesional në "Shkenca penale"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 597, datë 28.05.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 585, datë 27.11.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Shkenca Penale"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Privat "Albanian University"
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve	11 studentë
	Etj	

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional (MP) në “Shkenca Penale”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm periodik të programit të studimit MP në “Shkenca Penale” të Universitetit Jopublik “Albanian University”, Tiranë. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit, dosjen e programit të studimit me dokumentacionin shoqërues, takimet e vizitat e organizuara në institucion.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit akademik, aktivitetin kërkimor - shkencor dhe atë ekstrakurrikular, kujdesin ndaj studentit, këshillimin e karrierës dhe tutoriatin, praktikën profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar, etj.

Albanian University e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Albanian University është institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë i njohur si “Universitet” me VKM Nr.197, datë 10.04.2004. Albanian University është person juridik privat. Emri i Institucionit është ndryshuar nga UFO University në Albanian University me VKM Nr. 603, datë 24.03.2011.

Albanian University, aktualisht pas riorganizimit të miratuar me Urdhër Nr. 52, datë 05.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njëjësive përbërëse kryesore, bazë dhe ndihmëse.

Programi Master Profesional në “Shkenca Penale” është akredituar me Urdhër Nr. 585, datë 27.11.2012 (Evidenca H.6).

Ky program ka për qëllim që nëpërmjet përgatitjes teoriko – praktike t’u krijojë mundësi studentëve të ushtrojnë profesionin e juristit dhe të bëjë një lidhje sa më të mirë me nevojat e tregut të punës.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.Dr. Migena Leskoviku
2. Prof.Asoc.Dr. Alketa Elezi

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ-ja u shoqërua nga specialistet e ASCAL, Msc. Ersi Dako dhe Msc. Emisa Isufaj. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako. Më datë 13.03.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 13/16, datë 13.03.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, i hartuar nga ekspertet e jashtme të vlerësimit.

Më datë 18.03.2019, Institucioni, me shkresë zyrtare Nr. 133/1 Prot., datë 18.03.2019, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës Nr. 13/16 Prot., datë 13.03.2019”, përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij.

Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

1. Biblioteka të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës.
2. Të rritet numri i personelit akademik me eksperiencë akademike të huaj për të rritur brenda auditorit procesin e të menduarit kritik.
3. Të krijohet lidhje më të mira me tregun e punës dhe statistika për të patur njohje me atë çfarë tregu i punës ofron.
4. Kërkimi shkencor duhet të jëtë në një nivel të atillë që të jetë sa i më i krahasueshëm me nivelin europian.
5. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. Për rekomandimin "*Biblioteka të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës*", rezulton se në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Shkencave Juridike, funksionon një sallë biblioteke për të plotësuar nevojat e studentëve gjatë ndjekjes së programit të studimit MP "Shkenca penale", duke shërbyer njëkohësisht edhe si sallë studimi. Biblioteka ka të skeduar 172 tituj tekste mësimore, artistike dhe revista të ndryshme. Pjesë e bibliotekës janë edhe bibliotekat online si Questia, ERIC, etj. Ambienti i bibliotekës i siguron studentëve një mjedis të qetë për të studiuar, por të kufizuar në një kapacitet prej 26 vendesh. Po ashtu, duhet bërë një sistemim më i mirë i fondit të bibliotekës si dhe shtimi i titujve me literaturë të huaj. Gjithashtu mendojmë se duhet të shihet mundësia që aksesin në bibliotekë dhe fondin e saj të vijojë për studentët e nivelit master, edhe pas orës 16:00, për të krijuar më shumë komoditet për studentët e këtij programi. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.
2. Për rekomandimin "*Të rritet numri i personelit akademik me eksperiencë akademike të huaj për të rritur brenda auditorit procesin e të menduarit kritik*", stafi akademik që rekrutohet synohet të ketë kualifikimet e nevojshme akademike, ku preferohen persona me tituj e grada shkencore, profesionistë të njohur të fushës dhe me eksperiencë profesionale, apo të rinj që janë shkolluar në universitetet e huaja, si p.sh. Itali, Bullgari. Kjo me qëllim që të garantohet një shërbim cilësor bashkëkohor ndaj studentëve të këtij programi. Në rradhët e këtij stafi Departamenti i Shkencave Juridike ka angazhuar edhe staf akademik të kualifikuar/specializuar në Shqipëri por që mund të kenë kryer trajnime jashtë vendit. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar.
3. Për rekomandimin "*Të krijohet lidhje më të mira me tregun e punës dhe statistika për të patur njohje me atë çfarë tregu i punës ofron*", Departamenti i Shkencave Juridike ka kryer tashmë një studim të tregut të punës. Gjithashtu ai ka dhe 14 marrëveshje bashkëpunimi me institucione/organizata dhe subjekte private vendase, të cilat krijojnë mundësi për bashkëpunimin institucional dhe lidhje më të mira me tregun e punës si dhe për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve, apo edhe për kryerjen e intershipeve. Mbështetje në mbarëvajtjen e procesit jep edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit duke siguruar komunikimin e duhur me institucionet e mundshme për të zhvilluar praktikën si dhe për internship-e të ndryshme. Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të parë mundësinë e ndjekjes së studimeve të mëtejshme në cikle të tjera, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Kjo zyrë mban dhe përditëson statistikën mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit MP "Shkenca Penale" si dhe harton një bazë të dhënash mbi pozicionet e punësimit të tyre në vende pune të ndryshme, si dhe

mban kontakte me këta studentë dhe shërben si urë lidhëse mes universitetit, studentëve, tregut të punës. Nga ana tjetër Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, ndihmon studentët qoftë me orientimet për të aplikuar për një vend pune po ashtu edhe duke i mbajtur gjithmonë në kontakt për mundësitë e reja që dalin për punësim. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar.

4. Për rekomandimin “*Kërkimi shkencor duhet të jetë në një nivel të atillë që të jetë sa më i krahasueshëm me nivelin europian*”, Departamenti i Shkencave Juridike ka bashkëpunim të ngushtë dhe me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Në këtë aspekt theksohet realizimi i përvitshëm i një konference shkencore ndërkombëtare, ku personeli akademik me kohë të plotë përjashtohet nga detyrimi për pagimin e fee së konferencës. Po ashtu, ky staf motivohet të publikojë artikuj shkencorë në revistën e AU-së “Optime”, pa pagesë, sipas fushave të interesit. Departamenti duhet ndër të tjera, të bashkërendojë punën me këtë zyrë për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe duhet të kontribuojë në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare Megjithatë, pavarësisht disa aplikimeve, deri tani nuk ka ndonjë projekt të fituar. Janë bërë disa aplikime për projekte nga ana e Departamentit të Shkencave Juridike, ku disa kanë marrë përgjigje negative, ndërsa për disa të tjera ende pritet përgjigje. Nga sa konstatohet, kjo nuk është e mjaftueshme për një kërkim cilësor të standardeve europiane dhe duhen bërë më shumë përpjekje për rritjen e bashkëpunimit me institucione vendase apo të huaja në këtë drejtim si dhe të aplikimit për projekte të ndryshme europiane apo ndërkombëtare me interes dhe impakt në fushën juridike. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.

5. Për rekomandimin “*Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare*”, institucioni shprehet se në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional nuk parashikohet një detyrim i tillë si në fazën e regjistrimit ashtu edhe në atë të diplomimit.

Ligji Nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri*”, në nenin 75/6 përcakton se programet e studimeve “Master Profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar, por ky ligj nuk bën përcaktim për njohjen e gjuhës së huaj si kriter pranimit për këtë program studimi (ndryshe nga sa përcakton shprehimisht për Masterin e Shkencave në nenin 76/4 të tij). Në zbatim të këtij ligji, Udhëzimi i MASR Nr. 52, datë 03.12.2015 “*Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë*”, i ndryshuar, përcakton në pikën 3 të tij se për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit.

Në nenin 76/1 ligji përcakton se pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.

Në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në nenin 25/4 me titull “Programet e studimit të ciklit të dytë: përcaktohet se “*Studentët e këtyre programeve studimi duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare*”, pa bërë dallimin mes tyre, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe programet e studimit master profesional.

Për sa më sipër, ndonëse gjuha e huaj nuk është më kriter detyrues për MP, ajo që do t'i sugjerohej AU-së, është që të përcaktohet në rregulloren e brendshme të programit të studimit niveli B1 i njohjes së gjuhës së huaj, si kriter hyrës, nëse ky do të ruhet si kriter pranimit në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, edhe për programet e studimit MP që ky fakultet ofron.

AU është një qendër e autorizuar për testimin e gjuhës angleze Toeic, L&R, APTIS dhe Cambridge, gjë që ofron dhe komoditet për studentët, duke qenë se stafi administrativ informon dhe lehtëson për ta procesin e regjistrimit, si dhe tërheqjen e certifikatave në këtë institucion.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Albanian University (AU) funksionon si institucion jopublik i arsimit të lartë, me statusin e universitetit dhe është person juridik që financohet nga burime të veta të ligjshme dhe burime të tjera të ligjshme. Veprimtaria e tij bazohet në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë si dhe në aktet e brendshme rregullatore të miratuara (Evidenca 2.1). AU ofron programe në të tre ciklet e studimit (Evidenca 2.1, neni 7).

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Shkenca penale” është licensuar me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009, “Për ndryshimin e emrit dhe për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë Shkollës së Lartë Universitare Private “UFO DENTAL”” (Evidenca 1). Mbi këtë bazë, doli Urdhëri i MASH Nr. 308, datë 08.06.2010 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike rrethje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit, Shkollës së Lartë Universitare Private “UFO University”, Tiranë” (Evidenca 1.A). Me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 393, datë 26.10.2012 u dha vlerësimi përfundimtar pozitiv për programin e studimit MP në “Shkenca penale” dhe përfundimisht ky program studimi u akreditua me Urdhërin e MASH Nr. 585, datë 27.11.2012 “Për akreditimin e programeve të studimit “Master Profesional” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, “E drejtë private”, “Shkenca Penale” të Universitetit “Albanian University” ” (Evidenca H.6).

Programi i studimit MP në “Shkenca penale” u ofron studentëve arsimim dhe trajnim të mëtijshëm profesional, në fushën e të drejtës penale dhe shkencave penale në tërësi. Në përfundim të programit të studimit jepet diploma “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer (Evidenca 3.5, neni 25). Ky program ka për qëllim kryesor të kontribuojë në rritjen e cilësisë profesionale të studentëve, të thellimit të njohurive të tyre në fushën juridike dhe që duan të vijojnë më tej karrierën e tyre profesionale në fushën e shkencave penale, të specializuar në këtë drejtim (Evidenca 1.1). (Evidenca 1.1.A). Ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit (Evidenca 1.1.A, neni 4/2).

Strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

AU ka adoptuar një strategji afatshkurtër dhe afatmesme për përmbushjen e vizionit dhe misionit të tij, për të garantuar suksesin në të ardhmen. Këto drejtime strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë objektivash të ndërlidhura mes tyre. Në përmbushje të misionit të tij, AU synon që planin strategjik ta përshtasë në koherencë me zhvillimet rajonale e globale (Evidenca 1.4). Në përmbushje të strategjisë së institucionit, Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar edhe planin e tij strategjik për vitin akademik 2018-2019 (strategji afatshkurtër), përmes së cilë synon të identifikohet si një alterantivë e besueshme, profesionale dhe konkurruese në fushën e arsimit të lartë në vend (Evidenca 1.2). Ky departament, nisur nga zhvillimet në sferën e arsimit të lartë, duke veçuar këtu ndryshimet që priten në lidhje me programin e drejtësisë, për kalimin nga niveli Bachelor me kohëzgjatje 3 vite akademike në ciklin e integruar të studimeve me kohëzgjatje 5 vite akademike, synon të ofrojë standarde dhe cilësi për studentët e këtij programi, për të përgatitur juristë të specializuar, në përshtatje me zhvillimet ekonomike e sociale të vendit dhe nevojat e tregut të punës (Evidenca 1.2).

Në 5 vitet e ardhshme (strategji afatmesme), AU ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm dhe konsolidimin e programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktit social për programet që ofron, ku përfshihet edhe ky program i ciklit të dytë të studimeve. Objektivat afatgjata synojnë të sigurojnë rritje cilësore në përgatitjen e brezave për t’iu përgjigjur ekonomisë së tregut, nevojave për juristë të specializuar dhe rritjes së nivelit mësimor e kërkimor të

krahasueshëm me standartet e universiteteve perëndimore, si një qendër me rëndësi e arsimit jo publik në vend.

Në objektivat e AU-së përfshihet edhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve përmes zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe cilësisë. Në lidhje me mësimdhënien, objektiv mbetet adoptimi i metodologjisë moderne interaktive që inkurajon të menduarin kritik dhe vendos studentin në qendër të vëmendjes (Evidenca 1.4, fq.11).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
<p>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p>	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Shkencave penale” është një nga programet e ciklit të dytë që ofrohen nga Departamenti i Shkencave Juridike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, AU. Ky program studimi ofrohet në përputhje me strategjinë e miratuar nga institucioni si dhe misionin e tij.</p> <p>Ky program studimi, ashtu si edhe çdo program tjetër që ofrohet nga ky departament, në të gjitha ciklet e studimit, synon të mbajë parasysh nevojat e studentëve, t’i përgjigjet zhvillimeve të kohës për një arsim të lartë cilësor, të përgatisë specialistë në fushat përkatëse dhe kërkues të rinj, për të kontribuar në zhvillimin e vendit por edhe më gjerë, nëpërmjet konsolidimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale (Evidenca 1.4).</p> <p>Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë juristë të specializuar në fushën e shkencave penale, nëpërmjet kombinimit të aspektit të njohurive të thelluara teorike me aspektin praktik, përmes bashkëpunimit me organe të sistemit të drejtësisë apo edhe me subjekte të tjera publike apo private, vendase apo të huaja, pranë të cilave do të zhvillohen stazhi dhe praktika profesionale (Evidenca 1.1.A dhe Evidenca 1.1).</p> <p>Studentët që ndjekin dhe përfundojnë këtë program studimi do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e dijeve dhe formimit që studentët e këtij programi kanë përfutur, në fushën e shkencave penale.</p> <p>Gjithashtu, ky program studimi është ndërtuar dhe azhornuar për t’iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë, por edhe në fushën e drejtësisë, reformave institucionale që kanë ndodhur në vend, reformës</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>në drejtësi, ecurisë së proceseve të integritetit evropian të vendit, etj. Qëllimi ka qenë përshtatja me ndryshimet e legjislacionit të arsimit të lartë dhe qenia në koherencë me nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar (Evidenca 6.2, Evidenca 7.2 dhe Evidenca 1.2).</p> <p>Rishikimi i programeve bëhet nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Kjo ka ndodhur edhe në rastin e rishikimit të këtij programi studimi, që është përshtatur në raport me kornizën ligjore në fuqi, dhe është miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të AU-së, Nr. 6, dt. 28.02.2018 (Evidenca 3.4).</p> <p>Po ashtu, siç doli edhe nga biseda me pedagogët e kontaktuar gjatë vizitës në institucion, duhet theksuar se nga ana e pedagogëve rishikohen syllabuset për të përditësuar materialin që u ofrohet studentëve, tema të caktuara leksionesh, kazuse dhe raste studimore të përditësuara që trajtohen gjatë orëve të mësimet.</p> <p>Programet e studimit që ofrohen synojnë të kontribuojnë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve të denjë për një shoqëri bashkëkohore, duke u bërë kështu përçues dhe mbrojtës të vlerave kulturore kombëtare (Evidenca 1.4 dhe Evidenca 1.2).</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Në planin strategjik 5 vjeçar 2017-2022 institucioni angazhohet në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të konsolidimit të programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktin shoqëror për këto programe studimi që ofrohen (Evidenca 1.4). Programi i studimit MP “Shkenca penale” që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike është hartuar në përputhje me këtë strategji 5 vjeçare për zhvillimin e IAL-së. Për këtë qëllim, Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar strategjinë e tij (Evidencë 1.2), si dhe ka përcaktuar në të objektivat afatshkurtra për vitin akademik 2018-2019 në përgjigje të objektivave strategjike institucionale.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e</p>	<p>Programi MP në “Shkenca penale” është përshtatur dhe riorganizuar për vitin akademik 2018-2019 sipas legjislacionit për arsimin e lartë në fuqi, për të kaluar nga sistemi me 90 ECTS dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike, në 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik (Evidenca 3.4).</p>

Kualifikimit.

Shih edhe tabelën 10 dhe 11 të anekseve).
Plani mësimor i programit të studimit MP në “Shkenca penale” nga akreditimi i parë, është ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të AU-së, Nr. 6, dt. 28.02.2018, në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore për këtë qëllim. Kështu, nga sa rezultojnë nga dokumentacioni i paraqitur nga AU dhe nga takimet e zhvilluara me pedagogët apo dhe përfaqësues të tjerë të institucionit gjatë vizitës në institucion, ky program studimi është rishikuar në përputhje me këto ndryshime/nevoja të sipërpërmendura (Evidenca 3.4).
Rregulla të mëtejshme në lidhje me këtë program studimi, janë përcaktuar në rregulloren e këtij programi, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të miratuara nga institucioni. (Evidenca 1.1.A).

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.


AU ka të miratuar Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022, të miratuar me Vendimin Nr. 14, dt. 03/07/2018 të Bordit të Administrimit mbi bazën e propozimit të Senatit Akademik të AU-së (Evidenca 1.4).

Në planin strategjik të tij, AU parashikon angazhimin për përmirësimin e vazhdueshëm dhe konsolidimin e programeve të studimit që ofron, përfshirë edhe programin MP “Shkenca penale”, në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktin shoqëror.

Në këtë strategji 5 vjeçare përcaktohet se qëllim dhe objektivi i institucionit është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, të metodave moderne interaktive të mësimdhënies dhe nxitjes së të menduarit kritik (Evidenca 1.4, fq. 11-12).

Po ashtu, vëmendje i kushtohet përditësimit të syllabuseve dhe materialeve që ofrohen në to, përfshirë edhe këtë program studimi. Teknikat e mësimdhënies dhe përmbajtja e kurrikulës do të përshtatet në raport me nevojat e tregut të punës, për t’u orientuar sa më mirë profesionalisht në treg.

Një ndihmesë në këtë drejtim sjell edhe bashkëpunimi me NJSBC-në, për të analizuar të dhënat që dalin nga mendimet dhe feedback-u i studentëve për këtë program studimi dhe cilësinë e tij dhe të pedagogëve që angazhohen në këtë program.



Konkluzionet e vlerësimit:

Programet e ciklit të dytë Master Profesional që ofrohen nga Departamenti i Shkencave Juridike janë në përputhje me misionin e universitetit dhe qëllimin e tij.

Programi i studimit MP në "Shkenca penale" është ndërtuar në bazë të strategjisë 5 vjeçare të zhvillimit institucional 2017-2022 të miratuar nga Senati Akademik i AU-së. Ky program është orientuar drejt nevojave të tregut të punës dhe synon të përgatisë juristë të specializuar në fushën e së drejtës penale dhe shkencave penale në tërësi.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në fuqi, si dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga AU.

Institucioni ka hartuar një strategji zhvillimi 5 vjeçare, dhe në përputhje me të edhe Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar strategjinë e tij të re të zhvillimit për vitin akademik 2018-2019, të orientuar drejt cilësisë, të rezultateve të mësimdhënies dhe nxënies.

Programi i studimit MP në "Shkenca penale" ka për qëllim të kontribuojë në përgatitjen e juristëve të profilizuar në shkenca penale, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit, si dhe duke u bërë përçues dhe mbrojtës të interesave dhe vlerave kulturore kombëtare.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore e AU-së, që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura me profilet shoqërore të njohura dhe licensuara nga organet shtetërore kompetente (Evidenca 3.5, neni 1). Ky fakultet ofron disa lloje programesh, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit, në përfundim të të cilave lëshohet diploma përkatëse për studentët që frekuentojnë këto programe.

Bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, ky fakultet ka strukturën e tij përbërëse, që përfshin 4 departamente (Evidenca 2.5 dhe Evidenca 3.5, neni 7/4), si njësi bazë mësimore/kërkimore:

- Departamentin e Shkencave Juridike;
- Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative;
- Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme;
- Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes.

Departamenti i Shkencave Juridike është njësi bazë mësimore dhe kërkimore - shkencore në Fakultet, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU-së, dhe aktet e tjera rregullatore, që ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. (Evidenca 3.5, neni 12/1 dhe Evidenca 2.6, neni 4).

Në krye të departamentit qëndron Përgjegjësi i Departamentit, i cili është autoriteti akademik më i lartë drejtues i njësisë bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton dekanit (Evidenca 3.5, neni 13 dhe Evidenca 2.6, neni 9). Mësimdhënia dhe aktiviteti kërkimor-shkencor ofrohen sipas standardeve të vendosura nga AU, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Departamenti ndahet në grupe mësimore, si njësi përbërëse mësimore-kërkimore të departamentit që mbulojnë një ose më shumë disiplina të ngjashme të formimit të përgjithshëm ose profesional. Aktualisht Departamenti i Shkencave Juridike ka në përbërje të tij 3 grupe të tilla mësimore: grupi mësimor i të drejtës publike, i të drejtës penale dhe i të drejtës civile (Evidenca 2.6, neni 8). Çdo grup mësimor drejtohet nga një koordinator i cili duhet të ketë të paktën gradën shkencore 'Doktor' (Evidenca 2.6, neni 11) dhe përgjigjet për mbarëvajtjen normale të procesit mësimor apo atij kërkimor në disiplinën që mbulojnë, si dhe realizimin e programeve mësimore që mbulojnë.

Në përbërje të departamentit bën pjesë personeli akademik me kontratë me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, që përfshin staf nga të gjitha kategoritë: profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë, apo edhe

personel akademik i ftuar (Evidenca 3.5, neni 19/1 dhe Evidenca 2.1, neni 35, 37-38). Të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen në kontratën e punës (Evidenca 2.2.a dhe 2.2.b), bazuar në legjislacionin e punës dhe të arsimit të lartë në fuqi. Zyra e Burimeve Njerëzore e universitetit menaxhon dosjet e personelit akademik si dhe i azhuron ato me të dhëna apo dokumentacionin e nevojshëm, gjë që u konstatua edhe gjatë vizitës së GVJ-së në institucion dhe kontaktit me personin përgjegjës të kësaj zyre. Gjithashtu, Zyra e Burimeve Njerëzore publikon vendet vakante për personel akademik dhe kriteret për këto vende, si në faqen e internetit apo edhe në mjete të tjera të informimit publik (Evidenca 6.2, fq.18 dhe Evidenca 3.10). Një shembull i rekrutimit të stafit akademik, në raste vendesh të lira, jepet në Evidencën 3.5.A.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka një strukturë prej 4 departamentesh (siç u përmend më sipër), ku një prej tyre është Departamenti i Shkencave Juridike që mbulon dhe është përgjegjës për programin e studimit MP "Shkenca penale".

Dekani është drejtuesi i Fakultetit me titullin shkencor "Profesor" ndërsa Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike mban gradën shkencore "Doktor". Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike është edhe koordinatori shkencor i programit të studimit MP "Shkenca penale".

Të dhëna për stafin akademik të Departamentit të Shkencave Juridike

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Në përbërje të këtij stafi marrin pjesë specialistë të fushës juridike, me tituj e grada shkencore ose që kanë specializime të ndryshme, magistratë apo edhe staf me diplomën "Master i Shkencave".

Në lidhje me të dhënat e deklaruara nga institucioni në RVB (Tabela 1 e RVB-së, fq. 8-9), për Departamentin e Shkencave Juridike rezulton se ka një ndryshim nga sa ne konstatuam dhe morëm si të dhëna gjatë vizitës në institucion. Konkretisht, nga të dhënat e marra nga GVJ nga Zyra e Burimeve Njerëzore e AU-së, për vitin akademik 2018-2019 rezulton se numri i PAE është 10 dhe numri i PAK është 22. Këto të dhëna për stafin akademik të Departamentit të Shkencave Juridike në ndarjen PAE dhe PAK si dhe kualifikimin e tyre (tituj, grada, diploma) jepen në tabelën 1 të anekseve të këtij raporti.

Në strukturën e këtij departamenti, (sipas Evidencës 2.3 dhe Evidencës 2.4), angazhimi i pedagogëve në vitet e tjera ka qenë si vijon:

- për vitin akademik 2017-2018 bënë pjesë 13 personel akademik me kohë të plotë (PAE) si dhe janë angazhuar 19 me kohë të pjesshme (PAK);
- në vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 14 PAE dhe 23 PAK;
- në vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 16 PAE dhe 33 PAK;
- në vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar 15 PAE dhe 40 PAK;
- në vitin akademik 2013-2014 janë angazhuar 18 PAE dhe 61 PAK;
- në vitin akademik 2012-2013 janë angazhuar 10 PAE dhe 72 PAK.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	AU është organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	

Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;

Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".

Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të këtij ligji si dhe të akteve rregullatore të brendshme të institucionit.

AU është IAL jopublike, që gëzon statusin e universitetit, dhe si i tillë ka një organizim që i përgjigjet misionit të tij për të ofruar mësimdhënie dhe kërkim shkencor cilësor, në të tre ciklet e studimit që ky universitet ofron. (Evidenca 2.1).

Organizimi i brendshëm i AU-së ka në përbërje të tij njësi bazë, njësi kryesore, njësi ndihmëse dhe shërbimi, si dhe njësi administrative sipas rregullimeve që bën Statuti i AU-së dhe Rregullorja e Përgjithshme e tij. (Evidenca 2.1, neni 9). Kjo strukturë është miratuar nga MASR dhe mund të ndryshojë vetëm në funksion të llojeve dhe programeve të studimit që ofron (Evidenca 2.1, neni 10).

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, AU përbëhet nga 3 Fakultete si njësi kryesore, ku një prej tyre është edhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

Secili prej fakulteteve ka të paktën 3 departamente si njësi bazë të tij. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka një strukturë të përbërë prej 4 departamentesh, që janë: Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Objektivat dhe misioni i njësisive bazë përcaktohet në aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Departamenti i Shkencave Shoqërore ka edhe rregulloren e tij të brendshme si dhe rregullore të programeve të studimit që ofron, si dhe ka hartuar dhe miratuar planin e tij strategjik për vitin akademik 2018-2019.

Departamenti i Shkencave Juridike ka aktualisht në përbërjen e tij 10 anëtarë si staf akademik efektiv, me kualifikimin si vijon: 5 pedagogë kanë gradën shkencore "Doktor", 2 pedagogë janë në vijim të studimeve doktorale dhe 3 pedagogë janë asistent-lektorë dhe zotërojnë diplomën "Master i Shkencave". (Tabela 1 e anekseve).

Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 13 PAE, me kualifikimin si vijon: 1 Prof.Asoc, 6 pedagogë kishin gradën shkencore "Doktor", 2 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 4 pedagogë asistent-lektorë me diplomën "Master i Shkencave" (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Për vitin akademik 2016-2017, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 14 PAE, me kualifikimin si vijon: 1 Prof.Asoc, 5 pedagogë kishin gradën shkencore “Doktor”, 4 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 4 pedagogë asistent-lektorë me diplomën “Master i Shkencave” (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Për vitin akademik 2015-2016, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 16 PAE, me kualifikimin si vijon: 1 Prof.Asoc, 3 pedagogë kishin gradën shkencore “Doktor”, 8 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 4 pedagogë asistent-lektorë me diplomën “Master i Shkencave” (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Për vitin akademik 2014-2015, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 15 PAE, me kualifikimin si vijon: 1 Prof.Asoc, 5 pedagogë kishin gradën shkencore “Doktor”, 4 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 5 pedagogë asistent-lektorë me diplomën “Master i Shkencave” (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Për vitin akademik 2013-2014, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 18 PAE, me kualifikimin si vijon: 2 Prof.Asoc, 4 pedagogë kishin gradën shkencore “Doktor”, 7 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 5 pedagogë asistent-lektorë me diplomën “Master i Shkencave” (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Për vitin akademik 2012-2013, Departamenti i Shkencave Juridike kishte në përbërjen e tij 10 PAE, me kualifikimin si vijon: 2 Prof.Asoc, 2 pedagogë kishin gradën shkencore “Doktor”, 2 pedagogë në vijim të studimeve doktorale dhe 4 pedagogë asistent-lektorë me diplomën “Master i Shkencave” (Evidenca 2.3 dhe 2.4).

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike i këtij fakulteti, i kanë të përcaktuara përgjegjësitë e tyre në Statut dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU-së (Evidenca 2.1 dhe 1.3). Përcaktime më të hollësishme për këtë fakultet si njësi kryesore, strukturën/përbërjen, personelin akademik dhe atë administrativ, organizimin e studimeve dhe programet që ofron, studentët, kontrollin e njohurive dhe vlerësimin, përcaktohen në Rregulloren e këtij fakulteti (Evidenca 3.5). Ndërsa përcaktime në mënyrë të detajuar për

organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Shkencave Juridike, bëhen në Rregulloren e brendshme të këtij departamenti (Evidenca 2.6). Kështu kjo rregullore përcakton misionin dhe qëllimin e departamentit, organizimin dhe funksionimin e tij, organizimin e studimeve dhe programet e studimit që ofron (ku bën pjesë edhe programi i studimit MP "Shkenca Penale"), studentët, mësimdhënien, etj.

Në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat e evidentuara nga departamenti për personel akademik, përgjegjësi i departamentit i parashtron dekanit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Dekanati i Fakultetit ia përcjell këto kërkesa rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit, të cilat bëhen publike. (Evidenca 3.5 dhe 2.6). Këto njoftime vendosen në faqen web të institucionit <http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/>, (Evidenca 3.10) si dhe bëhen publike edhe përmes UTV-së.

Mbi këtë bazë, fakulteti krijon Komisionin e Vlerësimit me propozimin e përgjegjësit të departamentit, komision i cili bën përzgjedhjen e këtyre kandidaturave. (Evidenca 3.5.A). Ky Komision Vlerësimi prej 5 anëtarësh, ka në përbërje të tij dekanin e fakultetit, përgjegjësin e departamentit të shkencave juridike si dhe një pedagog të fushës nga ky department, si dhe një përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Kurrikulave (Evidenca 3.5, neni 19 dhe 3.5.A).

Konkluzionet e vlerësimit:

AU organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij për ofrimin e një arsimi dhe kërkimi shkencor cilësor. Organizimi dhe funksionimi i Departamentit të Shkencave Juridike dhe i programeve që ai ofron përcaktohen më hollësisht në rregulloren e brendshme të departamentit, e hartuar mbi bazë të akteve të tjera rregullatore të brendshme të nxjerra nga institucioni.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike angazhohen drejtpërdrejt në përzgjedhjen e personelit akademik për realizimin e programeve të studimeve që ofrojnë, si pjesë e Komisionit të Vlerësimit ad-hoc të ngritur për këtë qëllim, në bazë të një procedure konkurrimi, transparente, publike të parashikuar në rregulloret respektive të këtyre njësive.

Përzgjedhja e këtij personeli akademik bëhet mbi bazën e nevojave të departamentit, në përputhje me programet e studimeve që ofrojnë në cikle të ndryshme, e orientuar drejt një stafi sa më të kualifikuar dhe profesional që i përgjigjet kërkesave të programit të studimit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Shkencave Juridike si një nga 4 departamentet e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, ofron programin e studimit Master Profesional në "Shkenca penale", prej 60 ECTS dhe kohëzgjatje 1

vit akademik (e rishikuar me ndryshimet e kërkuara ligjore), në përfundim të të cilit lëshon diplomën përkatëse (Evidenca 2.6 dhe Evidenca 1.1.A).

Në këtë program studimi aktivizohet personel akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK).

Për vitin akademik 2018-2019, në këtë program studimi angazhohen në total 8 pedagogë, prej të cilëve 4 pedagogë PAE dhe 4 PAK (Tabela 3 e Anekseve). Kualifikimi i tyre paraqitet si vijon:

PAE: 3 Dr., 1 pedagogë në proces për mbrojtjen e Dr.

PAK: 1 Prof. Asoc, 1 Dr., 1 në proces për mbrojtjen e Dr, dhe 1 Msc.

Sipas Evidencës 3.2 dhe 3.1, si dhe tabelës 4 të anekseve, për vitet e tjera akademike stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, paraqitet si më poshtë:

- Për vitin akademik 2017-2018 ky numër është 2 PAE dhe 4 PAK.

PAE: 1 Dr dhe 1 në proces për mbrojtjen e Dr;

PAK: 1 Prof. Asoc, 1 në proces për mbrojtjen e Dr dhe 2 Msc.

- Për vitin akademik 2016-2017 ky numër është 3 PAE dhe 5 PAK.

PAE: 1 Dr dhe 2 në proces për mbrojtjen e Dr;

PAK: 2 Prof.Asoc, 1 Dr, 2 në proces për mbrojtjen e Dr dhe 1 Msc.

- Për vitin akademik 2015-2016 ky numër është 3 PAE dhe 4 PAK.

PAE: 1 Prof.Asoc, 2 në proces për mbrojtjen e Dr;

PAK: 1 Dr, 1 në proces për mbrojtjen e Dr dhe 2 Msc.

- Për vitin akademik 2014-2015 ky numër është 2 PAE dhe 8 PAK.

PAE: 2 në proces për mbrojtjen e Dr;

PAK: 1 Dr, 1 në proces për mbrojtjen e Dr dhe 2 Msc.

- Për vitin akademik 2013-2014 nuk është aktivizuar asnjë pedagog në këtë program studimi, pasi nuk ka pasur të regjistruar.

- Për vitin akademik 2012-2013 ky numër është 3 PAE dhe 7 PAK.

PAE: 1 Prof.Asoc, 1 në proces për mbrojtjen e Dr dhe 1 Msc;

PAK: 1 Prof.Asoc dhe 6 Msc.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, ku disa janë edhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies, me tituj dhe grada shkencore, apo eksperiencë në praktikë në pozicione të ndryshme.

Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. Për vlerësimin e kandidatave ngrihet një komision i posaçëm, i cili pasi shqyrton dosjen e kandidatëve të paraqitur, zhvillon edhe intervistën më gojë. Kandidati fitues firmos kontratën e punës me rektorin e AU-së. (Evidenca 2.1 dhe Evidenca 1.3, neni 30).

Kontratat e punës janë individuale të lidhura mes punëdhënësit dhe punëmarrësit bazuar në Kodin e Punës dhe legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, si dhe aktet e brendshme rregullatore të AU-së. Një model kontrate ndodhet në dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga IAL-ja (Evidenca 2.2.a për PAE dhe evidenca 2.2.b. për PAK).

Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mban dhe administron dosjet me të dhënat në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, kontratat, formën e punësimit (me kohë të plotë apo të pjesshme, etj).

Ngarkesa e personelit akademik përcaktohet duke iu referuar programit të studimit MP "Shkenca penale" dhe lëndëve të këtij programi, sipas fushave të ekspertizës së stafit akademik, përvojës së tyre profesionale dhe mësimdhënësë si dhe titujve akademikë dhe gradave shkencore që mbajnë. Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës jepet në Tabelën 12 të anekseve.

Ajo që vihet re në lidhje me stafin akademik ndër vite të aktivizuar në këtë program studimi, është se ky raport nuk respekton koeficientin/përqindjen 70 % PAE dhe 30 % PAK. Kjo gjë është pranuar edhe nga vetë institucioni dhe është pasqyruar në RVB (fq. 16) dhe po ashtu është konstatuar edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Në mbështetje të procesit akademik është edhe personeli ndihmës-akademik dhe administrativ. Për këtë program studimi, numri i këtij personeli për vitin akademik nga 2012-2013 deri 2017-2018 është 6 punonjës dhe 3 për vitin akademik 2018-2019 (Tabela 4 e anekseve).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Në lidhje me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, politika e departamentit dhe e AU-së në tërësi ka synuar pasjen e një stafi të qëndrueshëm dhe që i përgjigjet cilësisë së kërkuar dhe nevojave të kohës. I gjithë stafi akademik me kohë të plotë, ka kontratë punë pa afat me institucionin, gjë që krijon edhe garanci dhe jep premisa për qëndrueshmëri të këtij stafi. Stafit akademik qoftë me kohë të plotë ashtu edhe ai me kohë të pjesshme i kontaktuar gjatë vizitës në institucion, u shpreh i kënaqur me trajtimin dhe motivimin nga AU si dhe me respektimin e kontratave me institucionin. Nga sa kontaktua, në këtë departament përvoja e punës dhe angazhimi me këtë institucion varion diku filluar nga stafi më i ri me 2.5 vjet punë në institucion deri tek ata që konsiderohen më të vjetër në universitet, me eksperiencë prej 6 apo 7 vitesh në AU apo edhe nga ata që punojnë në këtë institucion që prej themelimit të tij në vitin 2006.

Të dhënat për stafin akademik të angazhuar dhe kualifikimet, si dhe ndarjen PAE/PAK paraqiten në tabelat 3-4 të anekseve të këtij raporti.

Në vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar për herë të parë në këtë program studimi 32 studentë dhe numri i pedagogëve të angazhuar ishte 10 pedagogë, dhe raporti PAE/PAK ka qenë 3/7; në vitin 2013-2014 nuk u regjistrua asnjë student. Ndërsa në vitin 2014-2015 u regjistruan për herë të parë 34 studentë dhe u regjistruan me transferim 14 studentë dhe u angazhuan 10 pedagogë në raportin PAE/PAK 2/8. Në vitin 2015-2016 u regjistruan 13 studentë për herë të parë dhe 2 studentë u regjistruan me transferim, si dhe dhanë mësim 7 pedagogë ku raporti PAE/PAK ishte 3/4. Në vitin akademik 2016-2017 u regjistruan për herë të parë në total 19 studentë dhe 1 me transferim, dhe u angazhuan 8 pedagogë në raportin PAE/PAK 3/5. Ndërsa në vitin akademik 2017-2018, u regjistruan për herë të parë 33 studentë dhe nuk pati studentë me transferim si dhe u angazhuan 6 pedagogë në raportin PAE/PAK 2/4. Ndërsa në vitin akademik 2018-2019, janë regjistruar për herë të parë 11 studentë dhe janë angazhuar 8 pedagogë në raportin PAE/PAK 4/4.

Siç u përmend më sipër, në vitin akademik 2013-2014 nuk u regjistrua asnjë student dhe për pasojë nuk u aktivizua asnjë pedagog në mësimdhënie në këtë program studimi.

Numri total i pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi prej vitit akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018 është 20 pedagogë (PAE+PAK). (Evidenca 3.1 dhe 3.2).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IL1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arrijtjen e tyre;

Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Departamenti në këtë program studimi angazhon personel akademik, personel ndihmës akademik dhe administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe të zhvillimit të institucionit. (Evidenca 2.1 dhe 1.3).

Për realizimin e objektivave të këtij programi studimi, personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i institucionit angazhohet dhe kryhen veprimtarinë e tij në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit, për të kontribuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe në veprimtarinë kërkimore-shkencore, apo në aktivitete të tjera të tij.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personeli akademik i departamentit diskuton mbi ndryshimet e mundshme në kuadër të përshtatjes së kurrikulës sipas kërkesave ligjore në fuqi. Për këtë qëllim, në mbledhje departamenti diskutohet mbi ndryshimet e mundshme në programet e studimit që ofron dhe bashkëpunon për këtë qëllim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, dhe angazhohet në grupet e ekspertëve në kuadër të rishikimit të kurrikulave. Kjo ka ndodhur edhe në rishikimin e programit MP "Shkenca penale" dhe përshtatjen e tij me 60 ECTS (Evidenca 3.4).

Çdo fillim viti, stafi akademik angazhohet në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, për ta përditësuar me tema apo literaturë/materiale të reja të përshtatshme për temën dhe në përputhje me zhvillimet në fushën e drejtësisë.

Në këtë program studimi, departamenti është përpjekur që të angazhojë pedagogë me tituj dhe grada shkencore, si dhe profesionistë me eksperiencë dhe që vijnë nga praktika. Disa prej anëtarëve të stafit akademik janë në proces të përfundimit të studimeve doktorale me qëllim avancimin e tyre akademik.

Rekrutimi i personelit të ri akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e departamentit. Ngarkesa totale në auditor për personelin akademik të anagazhuar dhe format e mësimdhënies në programin e studimit MP "Shkenca penale" jepet në tabelën 5.1 dhe 5.2 të anekseve.

Me riorganizimin e programit dhe daljen e akteve të reja nënligjore në lidhje me arsimin e lartë, institucioni ka marrë masa për përshtatjen e tyre me këtë legjislacion të ri. Kjo përshtatje mund të prekë edhe ngarkesën mësimore të stafit akademik me kohë të plotë/me kohë të pjesshme, sipas Udhëzimit Nr. 29, dt. 10/09/2018 të MASR "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit

akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Siç u vërejt edhe nga vizita në institucion, nuk ka përcaktim për ngarkesën mësimore të shprehur në orë mësimore vjetore në auditor; edhe kontrata me stafin akademik përcakton kohën javore të punës, por jo ngarkesën e pedagogut si më sipër. (Evidenca 2.2.a dhe 2.2.b). Kjo është përcaktuar edhe në Vendimin përkatës të Senatit Akademik të AU-së, në lidhje me ngarkesën mësimore – Vendimi i Senatit Akademik të AU-së, Nr. 46, datë 28/09/2018, ku përcaktohet se ngarkesa mësimore vjetore për autoritetet drejtuese, personelin akademik me kohë të plotë dhe personelin akademik me kohë të pjesshme, të jetë në përputhje me nevojat e njësisë bazë (departamentit). Kjo pasi Udhëzimi i lartpërmendur, për IAL-të jopublike parashikon se ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës të përcaktuar në Kodin e Punës.

Pavarësisht se AU nuk ka mospërbushje standarti në lidhje me këtë kriter (2), megjithatë, për të forcuar kërkimin shkencor dhe përcaktimin e një raporti mes veprimtarive të ndryshme që zhvillon PAE, GVJ sugjeron që të shihet mundësia, që në të ardhmen, institucioni të ketë një përcaktim të kësaj ngarkese vjetore në orë mësimore, në mënyrë që të krijohet hapësirë për më shumë veprimtari kërkimore e shkencore nga PAE; si dhe të mund të përcaktohet një raport ndërmjet veprimtarive të ndryshme ku anagazhohet personeli akademik me kohë të plotë, (neni 59 pika 2 dhe 7, dhe neni 95 i ligjit 80/2015); për t'i dhënë më shumë hapësirë ndërkombëtarizimit të stafit, aplikimit në projekte veçanërisht ndërkombëtare, etj. si dhe orientimit të stafit në raport me veprimtarinë mësimore apo kërkimore të zhvilluar (shih edhe Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR).

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike, ku thirrja pasqyrohet dhe në faqen web të universitetit apo edhe përmes UTV-së. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për vlerësimin e kandidatave ngrihet një komision i posaçëm, i cili pasi shqyrton

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

dosjen e kandidatëve të paraqitur, si zhvillon edhe intervistën më gojë. Kandidati fitues firmos kontratën e punës me rektorin e AU-së. (Evidenca 1.3, neni 30 dhe Evidenca 3.5, neni 19).

Personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në programin e studimit MP "Shkenca penale" nuk përbën min. 70% të personelit akademik të angazhuar për mbulimin e ngarkesës në këtë program studimi (pranuar dhe nga vetë IAL në fq. 16 të RVB). Kjo vihet re gjatë gjithë këtyre viteve të funksionimit të këtij programi.

Raporti PAE/PAK në aspektin numerik në %, për çdo vit akademik, PAE i angazhuar në këtë program studimi ka qenë:

- për vitin akademik 2018-2019, është 50 %;
- për vitin akademik 2017-2018, ka qenë 33 %;
- për vitin akademik 2016-2017, ka qenë 37,5 %;
- për vitin akademik 2015-2016, ka qenë 42,8 %;
- për vitin akademik 2014-2015, ka qenë 20 %;
- për vitin akademik 2013-2014 nuk ka pasur studentë të regjistruar;
- për vitin akademik 2012-2013, ka qenë 30 %.

Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të pedagogëve të departamentit që angazhohen në këtë program studimi, zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik me mbështetjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me anë të formave të ndryshme, si: pyetësorët e studentëve, fokus-grupet, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit si dhe vetëvlerësimi nga vetë pedagogu (Evidenca 3.6, 3.7 dhe 3.8).

Të dhënat për rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ mbahen dhe administrohen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të AU-së (Evidenca 2.1 dhe 1.3). Gjithashtu edhe Departamenti mban të dhënat e tij në lidhje me stafin akademik të rekrutuar dhe angazhimin e tij në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, sipas planit mësimor të këtij programi studimi (Shih tabelën 12 të anekseve).

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve Master ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve

Përgjegjësi i Departamentit është edhe përgjegjës i programit të studimit MP në "Shkenca penale". Ai ka gradën shkencore "Doktor" si dhe ka eksperiencë në fushën akademike.

Titullarët e lëndëve në këtë program studimi kanë titujt "Profesor i Asociuar" dhe gradën shkencore "Doktor".

Në radhën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, ka edhe pedagogë me eksperiencë në mësimdhënie, si edhe pedagogë të

“Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

specializuar në universitete perëndimore, që kanë kualifikime të ndryshme.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion (takimi me përgjegjësin e departamentit të shkencave juridike dhe takimi me stafiin akademik) bëhet dallimi mes titullarit dhe lektorit, në disa raste. Kjo pasi një pedagog (kryesisht me titull akademik) mund të dalë si titullar në disa lëndë, pavarësisht se jo gjithnjë mund të jetë lektor i tyre. Në këtë rast, titullari i lëndës përcakton aspekte të zhvillimit të lëndës, si dhe përmbajtjen e lëndës apo të temave që do trajtohen dhe përditësimin e materialit për tema të caktuara, por mund të mos jetë ai që zhvillon lëndën në auditor. Kjo është një qasje e brendshme e zgjedhur dhe e aplikuar nga departamenti, për lëndë apo titullarë të caktuar.

Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, janë të punësuar me kohë të plotë në AU.

Njësia bazë ka parashikuar një pedagog, i cili është përgjegjës për praktikat profesionale. Ky pedagog mbikëqyr këtë veprimtari dhe koordinon me institucionet dhe organizmat ku mund të zhvillohen praktikat profesionale.

Mbështetje në mbarëvajtjen e procesit jep edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit duke siguruar komunikimin e duhur me institucionet e mundshme për të zhvilluar praktikën si dhe për internship-e të ndryshme.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;


Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Studentët e programit të studimit MP “Shkenca penale” e mbyllin këtë program studimi me temë diplome, që e mbrojnë para komisionit të ngritur për këtë qëllim (Evidenca 1.1.A, Kreu V).

Departamenti ka vënë në dispozicion të studentëve një manual udhëzues “Si të shkruajmë një temë diplome” (Evidenca 3.9) dhe zhvillon orë të hapura për t’i orientuar studentët në lidhje me rregullat, udhëzimet, njohjen me infrastrukturën që kanë në dispozicion nga departamenti për realizimin e punimit të diplomës.

Stafi akademik i përcaktuar nga departamenti për të udhëhequr studentët e ciklit të dytë të studimeve MP “Shkenca penale” në përgatitjen e mikrotezës përgjithësisht kanë gradën Doktor, por ka edhe pedagogë udhëheqës që janë në proces doktorature dhe kanë kualifikimin Msc ose kanë kryer Shkollën e Magjistraturës. Çdo pedagog ka në udhëheqje 5 studentë, sipas përcaktimeve që bëhen në rregulloren e departamentit (Evidenca 2,6, neni 23).



Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv por edhe me kontratë, të profilizuar në fusha të caktuara të shkencave penale.

Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit, duke respektuar detyrimet për një temë diplome të nivelit MP, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në manualin për përgatitjen e temës së diplomës (Evidenca 2.6, neni 23 dhe Evidenca 3.9).

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Për shkak të specifikave të tij, në këtë program studimi nuk zhvillohen orë laboratorike.

Megjithatë laboratorët e institucionit (si p.sh. ai i informatikës) mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga stafi i departamentit të shkencave juridike për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, apo për hedhjen e të dhënave dhe të analizës statistikore (shih tabelën 6 të Aneksëve).

Departamenti i shkencave juridike ka angazhuar burime njerëzore të mjaftueshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca penale", si përsa i përket stafit akademik ashtu edhe atij ndihmës akademik dhe administrativ. Duhet përmendur se sic rezultoi nga të dhënat e analizuara në vite, shumica e stafit akademik janë PAK.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;


Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Departamenti dhe personeli akademik angazhohen në realizimin e ngarkesës mësimore sipas përcaktimeve në kontratën individuale të punës.

Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program të ciklit të dytë të studimeve shpërndahet në orë mësimore në auditor me leksione/seminare/ushtrime dhe orë pune individuale, si dhe orë në udhëheqje studentësh.

Ngarkesa vjetore mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi nuk përcaktohet më një marzh në orë mësimore, por në orë pune në javë (sipas kontratës së punës). Ajo varion sipas specifikave të mbulimit me lëndë në departament për çdo program studimi që ky departament ofron dhe mbulimit me lëndë nga stafi akademik efektiv apo me kontratë.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.



Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen (të paktën një herë në vit) në Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe në departament.

Institucioni mban dhe administron informacionin e përvitshëm lidhur me stafin akademik që angazhohet cdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar. Ky informacion bëhet edhe pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni (Evidenca 6.2). Po ashtu të dhënat mbahen edhe për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ dhe detyrat që realizon. Sipas nevojave të departamentit, zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me rektoratin, publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion vakant në faqen e internetit:

<http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-2/> si dhe me mjete të tjera të informimit publik, si p.sh UTV. (një shembull procedure rekrutimi jepet në Evidencën 3.5.A.)

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti në këtë program studimi angazhon personel akademik, personel ndihmës akademik dhe administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe të zhvillimit të institucionit, në përputhje me strategjinë institucionale të zhvillimit dhe strategjinë e departamentit.

Personeli akademik i departamentit ka diskutuar mbi ndryshimet në kuadër të përshtatjes së kurrikulës sipas kërkesave ligjore në fuqi (për kalimin e këtij programi studimi nga 90 në 60 ECTS) si dhe bashkëpunon me zyrat/strukturat e tjera të AU-së në politikat zhvillimore të tij.

Rekrutimi i personelit të ri akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e departamentit, përmes publikimit në fillim të cdo viti akademik, të vendve vakante në departament dhe kërkesave/kritereve për plotësimin e tyre. Kjo shpallje bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen web të institucionit apo edhe përmes UTV-së.

Konkurrimi për këto pozicion është i hapur dhe transparent, dhe bëhet sipas një procedurë (me dosje dhe me interviste me gojë) që përcaktohet qartë në statut dhe në rregulloret e brendshme të miratuara. Kandidatët e përzgjedhur fitues nënshkruajnë kontratën e punës me Rektorin e AU-së. GVJ konstatoi se të gjitha kontratat e personelit akademik me kohë të plotë, ishin lidhur pa afat.

Krahas stafit të ri, Departamenti ka bërë përpjekje për të zhvilluar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, duke angazhuar staf akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë në raport me programin e ofruar. Po ashtu rëndësi i kushtohet edhe stafit administrativ të angazhuar në këtë program studimi, për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të programit.

Ngarkesa mësimore vjetore e pedagogut (efektiv apo me kontratë) nuk përcaktohet/planifikohet në orë mësimore me një minimum apo maksimum, por përcaktohet në orë pune javore, në përputhje me kontratën individuale të punës. Një qasje kjo si zgjedhje e bërë nga institucioni dhe që pasqyrohet edhe në statut, rregulloret e brendshme dhe vendim të senatit akademik të AU-së.

Megjithatë, GVJ sugjeron që të shihet mundësia, që në të ardhmen, institucioni të ketë një përcaktim të kësaj ngarkese vjetore në orë mësimore, në mënyrë që të krijohet hapësirë për më shumë veprimtari kërkimore e shkencore nga PAE; si dhe të mund të përcaktohet një raport ndërmjet veprimtarive të ndryshme ku anagazhohet personeli akademik me kohë të plotë, (neni 59 pika 2 dhe 7, dhe neni 95 i ligjit 80/2015); për t'i dhënë më shumë hapësirë ndërkombëtarizimit të stafit,

aplikimit në projekte veçanërisht ndërkombëtare, etj. si dhe orientimit të stafit në raport me veprimtarinë mësimore apo kërkimore të zhvilluar (shih edhe Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR).

Përsa i përket stafit akademik efektiv, vihet re që nuk plotësohet kriteri ligjor i kërkuar për mbulimin min. prej 70% të këtij programi me PAE. Megjithatë, në këtë program studimi, departamenti ka bërë përpjekje që në përzgjedhjen e stafit me kontratë të marrë parasysh eksperiencën dhe kualifikimet që ata kanë në lidhje me programin e studimit Master Profesional në "Shkenca penale". Kështu në këtë program studimi janë përfshirë si staf akademik me kontratë: gjyqtarë, punonjës në Administratën Publike, pedagogë nga universitete të tjera të vendit, etj.

Ndërthurja e stafit akademik të ri me staf me eksperiencë bën të mundur shkëmbim përvojash si dhe alternon aspektin teorik me atë praktik. Institucioni (ZBNJ) dhe Departamenti i Shkencave Juridike disponojnë një bazë të dhënash për personelin akademik dhe atë mbështetës, e cila përditësohet çdo vit akademik.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

AU është i organizuar si një kampus me katër godina, të cilat ndodhen në qendër të Tiranës, pranë godinave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera për studentët, me një sipërfaqe prej 10718 m². Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon procesin akademik, bashkë me 3 departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në godinën qendrore, e cila ndodhet në Bulevardin Zogu I, me një sipërfaqe prej 3996 m² (Evidenca 4.1.), me 9 salla leksioni dhe 11 salla seminari si dhe 2 laboratorë ai i informatikës dhe laborator i edukimit figurativ (Evidenca 6.2).

Ndërtesa ka qenë ekzistuese dhe të gjitha ambientet e saj janë rikonstruktuar sipas kushteve bashkëkohore të adoptuara në klasa dhe laboratore për zhvillimin e aktivitetit akademik duke plotësuar kërkesat e secilit departament për të ofruar çdo program studimi.

Nga vëzhgimi i ambienteve, GVJ konstaton se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Rrjeti kompjuterik që përdoret nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës është i lidhur dhe ka shërbim interneti në të gjitha godinat e AU-së. Universiteti ka website-in e tij zyrtar <http://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/>, ku pasqyrohet aktiviteti i institucionit dhe publikohen të dhëna të ndryshme. Në lidhje me mjediset, infrastrukturën dhe kapacitetin e tyre për studentët dhe stafin, shih edhe tabelën 6 të anekseve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Salla e bibliotekës disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë relativisht të kufizuar për të plotësuar kërkesat e studentëve (26 vende). Biblioteka e Fakultetit shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti. Ajo përmban literaturë profesionale juridike kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të stafit akademik.

Nga informacioni që mori GVJ nga punonjësja e bibliotekës, në bibliotekë gjenden rreth 1538 tituj librash, nga të cilët në fushën juridike janë 172 tituj (Evidenca 4.3). Blerjet e fundit në fushën juridike janë bërë në vitin 2017, sipas nevojave të departamentit dhe kërkesave për tituj të rinj. Në momentin e vizitës në institucion, po sistemohej fondi i librave në këtë bibliotekë, ku skedimi i tyre me programin e ri të instaluar, do t'i shërbente ndarjes më të mirë por dhe menaxhimit më të mirë të titujve në fushën juridike. Shërbimi bibliotekar realizohet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Studentët regjistrohen përmes kartës së regjistrimit dhe mund të aksesojnë literaturë si në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj në ambientet e kësaj

biblioteke. Po ashtu edhe stafi akademik akseson dhe rekomandon këtë literaturë në funksion të lëndëve dhe moduleve në të cilat ata janë të angazhuar. Biblioteka në dispozicion të studentëve të fakultetit, funksionon në orarin 08.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe në orarin 08:00 - 12:00 ditën e shtunë, orar i cili gjithashtu është i afishuar. Ky orar vlen edhe për studentët e programit master. Biblioteka ofron një numër titujsh për të mbuluar programin e studimit MP "Shkenca penale", brenda totalit të titujve në fushën juridike. Synohet disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe bibliotekat elektronike, ku më kryesore është Questia, të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në fushën juridike. Ato janë në dispozicion për t'u aksesuar pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik.

Përgjithësisht për secilën lëndë, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë të detyrueshme (Evidenca 4.2) dhe për literaturën e rekomanduar. Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga AU Press apo shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Literatura është gjithashtu e parashikuar dhe e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde (Evidenca 4.4). Salla e konferencave është e pajisur me të gjithë teknologjinë multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave apo aktiviteteve me rëndësi dhe qendrën e përkthimit simultan që përdoret për ushtrimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare, sic janë: konferencat, seminarët, leksionet e hapura shkencore, etj.

Në infrastrukturën e tij, Fakulteti i Shkencave Shoqërore nuk ka laboratorë për efekt të specifikave të programit MP "Shkenca penale", por laborator i informatikës është në funksion edhe të studentëve të këtij programi studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>AU ndodhet në një zonë qendrore të kryeqytetit dhe përbëhet nga katër godina të ndara sipas fakulteteve përkatëse. Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon veprimtarinë e tij mësimore vetëm në mjediset e godinës qendrore të AU-së, me një sipërfaqe totale prej 3996 m². (Evidenca 4.1).</p> <p>AU i disponon këto mjedise mbi bazën e kontratave të rregullta, kontrata që përsëriten prej vitit 2006. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e aktivitetit akademik si dhe praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programit të studimit MP në "Shkenca Penale".</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo</p>	<p>Literatura bazë e paraqitur në çdo syllabus të këtij programi studimi përbëhet kryesisht nga botime juridike që përdoren në programe të të njëjtit nivel në universitetet publike, më së shumti në gjuhën shqipe (Evidenca 4.2).</p> <p>Në literaturën plotësuese rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga AU Press apo shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Biblioteka përmban literaturën kryesore që ofrohet në</p>

revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

syllabuset e MP "Shkenca penale" (Evidenca 4.4 dhe Evidenca 4.3), si dhe tekste mësimore/literaturë të rekomanduar në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Aty ka gjithashtu edhe literaturë në shqip apo gjuhë të huaj, për të realizuar kërkimin shkencor dhe përgatitur temën e diplomës për studentët e këtij programi (Evidenca 4.3).

Në bibliotekë, nga gjithsej 1538 tituj, 172 tituj i përkasin fushës juridike, e që janë të disponueshëm për pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, ku bën pjesë dhe literatura e detyrueshme e programit të studimit dhe e teksteve të Departamentit (Evidenca 4.2, Evidenca 4.3, Evidenca 4.4).

Biblioteka elektronike "Questia", ka rreth 83.000 libra akademike dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë, dhe që rezulton më e përdorshme për këtë program studimi. Ajo mund të aksesohet lirisht dhe pa pagesë gjatë 24 orëve, nga pedagogë dhe studentë. Gjithashtu botime të ndryshme mundësohen edhe nga ndërmarrja botuese Albanian University Press. Revista e universitetit "Optime" është një revistë periodike, që përmban punime shkencore me interes edhe për këtë program studimi (Evidenca 4.5).

Nuk ka një plan të detajuar paraprak për fondin e bibliotekës, me buxhetin e parashikuar për këtë qëllim. Por duhet nënvizuar se pasurimi i fondit të bibliotekës me tekste apo materiale të tjera plotësuese në fushën juridike bëhet mbi bazën e kërkesave dhe nevojave që evidentohen nga departamenti, në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët (Evidenca 6.2).

Nga informacioni që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, rezulton se blerjet e fundit në këtë drejtim janë bërë në vitin 2017.

Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte, dhe 08:00-12:00 ditën e shtunë. Për çdo student ka kartelë regjistrimi. Sipas GVJ-së, ky orar shërbimi jo gjithmonë mund të jetë i përshtatshëm për studentët e masterit profesional në "Shkenca penale" dhe mendojmë se mund të shihet mundësia që për studentët e ciklit të dytë të rishikohet ky orar në mënyrë që ajo të jetë e aksesueshme për ta.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të

Për zhvillimin sa më normal dhe cilësor të procesit mësimor në këtë program studimi, departamenti ka në dispozicion ambiente të përshtatshme, si: salla leksioni (9) dhe seminari (11), sallë konferencash/aktivitetesh, të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin cilësor të këtij procesi

përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

(Evidenca 6.2). Shih për këtë qëllim edhe tabelën 6 të anekseve.

Siç u vërejt edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion, sallat ndaheshin në salla leksioni dhe seminari, me kushte të mira dhe kapacitet mëse të mjaftueshëm për numrin e studentëve në këtë program studimi. Ambientet janë komode dhe të përshtatshme për mësimdhënie.

Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me mjete audio-vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku përfshihen kompjuterat personal (Pc), video projektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, etj. (Evidenca 6.2).

Për t'i ardhur në ndihmë studentëve të MP "Shkenca Ppnale" funksionon edhe laborator i informatikës, me kapacitet prej 30 personash. Ky laborator nëpërmjet programeve të instaluar i ndihmon studentët për esetë/detyrat në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave. Ky laborator i shërben studentëve të AU-së në disa programe studimi, sipas një orari të përcaktuar dhe të ndarë për studentë të programeve të ndryshme. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të AU-së gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.

Për shkak të natyrës së tij, programi MP "Shkenca Penale" nuk ka praktika laboratorike.

Konkluzionet e vlerësimit:

Për realizimin sa më cilësor të programit të studimit MP në "Shkenca penale" institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme. Kjo infrastrukturë ofron kushte dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, apo aktiviteteve të tjera, të pajisura me kompjuter, videoprojektor, flipcharte, etj., mjete/pajisje këto që lehtësojnë realizimin e programit të studimit MP në "Shkenca penale".

Pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore funksionon biblioteka e tij, e aksesueshme edhe për studentët e këtij program studimi të ciklit të dytë. Kjo bibliotekë ka kapacitet të kufizuar fizik prej 26 vendesh. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti. GVJ sugjeron të rishikohet orari i funksionimit të bibliotekës për studentët e ciklit të dytë në mënyrë që ajo të jetë sa më shumë e aksesueshme prej tyre.

Po ashtu, ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka online, pa pagesë, ku kryesore për këtë program studimi është Questia.

Për shkak të specifikës së këtij program studimi, nuk ka praktika laboratorike. Në dispozicion të studentëve është laborator i informatikës, që mund të përdoret për përgatitjen e eseve/punimeve të kursit në lëndë të ndryshme apo për përgatitjen e punimit të diplomës.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifat e shkollimit nga studentët dhe

të ardhura nga aktivitete të tjera tregtare apo shërbimi (kafe, menca, fotokopje, etj.) (Shih tabelën 7 të anekseve). Rreth 1/3 e këtyre të ardhurave shpenzohet për kosto të tilla si: qera objekti, mirëmbajtja, ngrohja/ftohja, pastrimi, etj.

AU bën kontroll dhe auditim çdo vit, në përfundim të të cilit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Auditimi i përvitshëm bëhet nga një kontabël i miratuar dhe i licensuar për këtë qëllim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Kostot operative ndryshojnë nga një program studimi tek tjetri. Kostoja për student në një vit akademik është 900 euro, për këtë program studimi.

Deri më sot, AU nuk ka përfituar nga ndonjë projekt apo grant kërkimor, apo shërbim konsulence, për këtë program studimi (Shih për këtë qëllim tabelën 7 të anekseve).

Situata financiare dhe bankare e AU-së dëshmon se institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e këtij programi studimi. Institucioni harton bilancin financiar, i cili përmban pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave që përftohen nga tarifat e shkollimit dhe kontribute të tjera financiare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU kryen auditim të brendshëm dhe të jashtëm. Zyra e auditimit të brendshëm, si pjesë e zyrës së financës, është në varësi të Bordit të Administrimit të AU-së dhe kryen kontrollin dhe auditimin vjetor financiar (Evidenca 2.1). Po ashtu, çdo vit institucioni i nënshtrohet edhe auditimit të jashtëm që kryhet nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për këtë qëllim.</p> <p>Në to paraqitet situata financiare e institucionit, për mënyrën e përdorimit të buxhetit në dispozicion për çdo program studimi; të ardhurat dhe shpenzimet, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.</p> <p>Aktualisht rezultojnë se AU nuk përfiton asnjë grant të huaj që mund të përfitohet nga kontratat e shërbimeve për programet e ciklit të dytë master.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>AU harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare.</p> <p>Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj.</p> <p>Nga sa vërehet, rezultojnë se AU ka qëndrueshmëri</p>

financiare dhe kapacitete të mjaftueshme financiare për të përballuar këtë program studimi si dhe për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Konkluzionet e vlerësimit:

AU kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm dhe të jashtëm mbi situatën e tij financiare. Në nivel të brendshëm, ky auditim kryhet nga Zyra e Auditimit në varësi të Bordit të Administrimit, ndërsa auditimi i jashtëm kryhet nga një ekspert kontabël i miratuar dhe regjistruar, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. Financimi dhe të ardhurat për Departamentin e Shkencave Juridike janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të AU-së.

GVJ konstatoi se të ardhurat kryesore vijnë kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe nga aktivitete apo shërbime tregtare të ofruara.

Rezultoni se Institucioni ka stabilitet financiar për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij.

Ajo që duhet theksuar lidhet me faktin se duhen bërë më shumë përpjekje për të përfutur grante të huaja dhe për t'u përfshirë më shumë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore


Për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur e vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në varësi të Komisionit për Vlerësimin Institucional (Evidenca 1.3, neni 14 dhe Evidenca 2.1, neni 66), konform kërkesave të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të AU-së. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon që prej vitit akademik 2009-2010, ngritur me vendim të Senatit Akademik të AU-së, një sistem tashmë i konsoliduar institucional. NJSBC gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe ka akses për të marrë dhe kontrolluar të gjitha të dhënat e nevojshme të veprimtarisë së institucionit. NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional si dhe bashkëpunon me ASCAL për trajnimin e anëtarëve të saj. (Evidenca 2.1).

Kjo njësi e zhvillon punën e saj sipas një kalendari të përcaktuar, e që më pas nxjerr raportet me gjetjet përkatëse. NJSBC për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor. (Evidenca 2.1, neni 67/2).

Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin mendimet e studentëve të shprehura në pyetësorët që organizohen për këtë qëllim në fund të çdo semestri, si dhe tërheqja e mendimit nga "fokus-grupet" me studentët nga ku merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog që angazhohet në auditor në procesin e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies dhe materialit të ofruar në syllabus, literatura, etj. (Evidenca 3.8).

Në fund të çdo semestri zhvillohen anketimet e studentëve përmes pyetësorëve në formë elektronike, duke ruajtur anonimat, dhe para sezonit të provimeve, në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive (Evidenca 3.7). Të dhënat e përfutura nga këta pyetësorë, pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij.

Po ashtu, edhe Përgjegjësi i Departamentit vlerëson sipas një formati të miratuar për këtë qëllim, stafin akademik të angazhuar në këtë departament gjatë vitit akademik, në disa komponentë: veprimtaria mësimore dhe veprimtaria shkencore/botuese e realizuar, marrëdhënia me studentët, korrektesa në çështjet administrative brenda departamentit (Evidenca 3.6). Pas plotësimit të tij, përgjegjësi i departamentit këtë formular vlerësimi ia bën me dije pedagogut përkatës duke i dhënë një kopje të tij,



dhe një kopje tjetër depozitohet në departament. Ky vlerësim bën pjesë në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së çdonjërit prej personelit akademik të departamentit.

Gjithashtu, në mënyrë periodike, NJSBC informon dekanin dhe përgjegjësën e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisive të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen.


Në përfundim të këtij procesi, NJSBC harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit ose/dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi e merr në shqyrtim, e miraton. Pas miratimit nga Senati Akademik i AU-së, ky raport publikohet edhe në faqen web të AU-së.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Në lidhje me cilësinë, theksi është vënë në forcimin e rolit dhe përgjegjësisë së departamentit në proceset akademike dhe përmirësimin e cilësisë si në aktivitetin akademik ashtu edhe atë kërkimor-shkencor. Në vitin 2016, me Vendim të Senatit Akademik të AU-së (Evidenca 6.1), u vendos ngritja e grupeve të brendshme të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti (Evidenca 6.1 dhe 6.2). Në Departamentin e Shkencave Juridike, 2 nga anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të këtij departamenti, janë gjithashtu pjesë e grupit të sigurimit të brendshëm të cilësisë (RVB, tabela 9, fq.29), gjë për të cilën GVJ u informua edhe gjatë vizitës në institucion. Kjo konsiderohet nga GVJ si një praktikë e mirë që duhet konsoliduar në vijim. Përbërja e NJSBC jepet në tabelën 8 të Aneksëve. Ajo që u evidentua si nga vizita në institucion ashtu edhe nga RVB (shih fq.29), rezultoi se numri i studentëve që kanë plotësuar pyetësorët është në masën 50 % për vitin akademik 2017-2018, apo edhe më i ulët në vite të tjera. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve, duke filluar nga ky vit akademik, studentëve u mundësohet që plotësimi i këtyre pyetësorëve online të bëhet edhe drejtpërdrejt nga celulari.

Siç rezultoi nga takimet gjatë vizitës në institucion me anëtarë të NJSBC-së, formati/struktura e pyetësorit të studentëve ka ndryshuar dhe ajo aktualisht përmban tre komponentë për të cilat duhet të shprehen ata: për pedagogun, për lëndën, për stafin administrativ (Evidenca 3.7). Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë. Disa nga pikat e forta për të cilat janë shprehur studentët përmendim: korrektesa e personelit akademik, cilësia e mësimdhënies nga ana e tyre, mbështetjen nga ana e stafit administrativ, etj. Ndërsa si pika të dobëta janë përmendur: penalizimi për shkak të mungesave dhe mungesa e fleksibilitetit për studentët e këtij programi, mungesa/mosfunksionimi i duhur në disa salla të sistemit të ngrohjes/ftohjes, mungesa e aktiviteteve ekstrakurrikulare me interes për studentët e këtij programi studimi, etj. (Evidenca 3.7 dhe Evidenca 6.2).

Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik. Pedagogu vlerësohet nga strukturat drejtuese të fakultetit (dekani, përgjegjësi i departamentit), në analizën e planit individual mësimor dhe shkencor si dhe performancën e tij. Po ashtu kontrolli i cilësisë monitorohet edhe nga përgjegjësi i departamentit të shkencave juridike, i cili plotëson për këtë qëllim formatin e vlerësimit për pedagogun që angazhohet në këtë departament (Evidenca 3.6). Kjo praktikë shërben për të bërë një vlerësim të cilësisë nga disa aktorë, me qëllim evidentimin e situatës dhe nxjerrjen e të dhënave të nevojshme për nivelin e cilësisë që ofrohet, përmes analizës SWOT. (Evidenca 6.2 dhe Evidenca 6.3). Nga viti akademik i kaluar, për herë të parë, është hartuar edhe një pyetësor që do të plotësohet në mënyrë të përvitshme nga personeli akademik dhe që njihet si pyetësor për pedagogët. Sipas të dhënave të marra nga vizita në institucion, rezultoi se nga 334 pedagogë të universitetit që u ftuan të marrin pjesë në plotësimin e këtij pyetësori, vetëm 190 prej tyre e kanë plotësuar. NJSBC përcakton standardet e brendshme të sigurimit të cilësisë si për veprimtarinë akademike ashtu edhe atë kërkimore-shkencore. Në lidhje me standardet e cilësisë për kërkimin shkencor është hartuar një format që pedagogët duhet ta plotësojnë në fillim të vitit akademik (si planifikim) dhe në fund të vitit akademik (realizimi i kësaj veprimtarie). Edhe kjo i nënshtrohet përpunimit dhe analizës, me qëllim evidentimin e nivelit të performancës dhe cilësisë së pedagogut në fushën e veprimtarisë akademike e kërkimit shkencor (Evidenca 10.2).



Po ashtu, NJSBC realizon edhe "fokus-grupe" me studentë, në grupe të vogla studentore (Evidenca 3.8). Në nivel departamenti, realizohet një fokus-grup në vit me studentët, si rregull në muajin dhjetor. Nga të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion, rezultoi se deri më tani (për tre vjet) janë realizuar 3 fokus-grupe me studentët e departamentit të shkencave juridike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; 	<p>AU ka përdorur në vazhdimësi instrumenta metodologjikë për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit MP "Shkenca penale". Informacioni vlerësues është përfshirë në vetëvlerësimin institucional për sigurimin e cilësisë. Të dhënat e vlerësimit, NJSBC i publikon në faqen zyrtare të AU-së (Evidenca 2.1, neni 67/6). Institucioni, në përfundim të çdo viti akademik, publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, pas miratimit nga Senati Akdemik i AU-së, duke përfshirë edhe analizën SWOT. Një shembull raporti i publikuar mund të aksesohet në adresën: http://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2017/04/Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017-Perfundimtar.pdf.</p> <p>Gjithashtu, siç u përmend më sipër, AU ka përdorur disa metoda për realizimin e vlerësimit, të tilla si: pyetësorë me studentët, fokus grupe me studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin nga përgjegjësi i departamentit, pyetësorë për pedagogë, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, vlerësim me pikë dhe notë, teste, etj.</p> <p>Në përfundim të semestrit të parë, departamenti dorëzon raportin semestral në të cilin, përveç të tjerave, pasqyrohen dhe rezultatet e studentëve (kalueshmëria) dhe rezultatet e anketave të zhvilluara me studentët (Evidenca 6.3).</p> <p>Në përfundim të semestrit të dytë, departamenti harton raportin vjetor, në të cilin pasqyrohen rezultatet vjetore dhe bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara (Evidenca 6.2).</p> <p>Institucioni përfshin të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Nga sa vihet re, kalueshmëria e studentëve është e lartë (Evidenca 6.2).</p> <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC-së përdor metoda</p>

<p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>të drejtëpërdrejta dhe mjete të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit, 1 në çdo semestër) • Fokus grupe (1 në vit, që zhvillohet në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj. (Evidenca 3.8). <p>Të drejtëpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëhet vlerësimi me nota dhe pikë; • Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare; • Bëhen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve. <p>(Evidenca 1.1 dhe Evidenca 1.1.A).</p>
--	--

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>AU publikon në faqen e internetit raportin vjetor të vetëvlerësimit, miratuar nga Senati Akademik, në përfundim të të cilit paraqitet analiza SWOT (Evidenca 6.2).</p> <p>Forma të tjera për vlerësimin e brendshëm, si: video, audio etj, nuk rezultojnë se bëhen dhe publikohen nga AU.</p>
---	--

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Në përfundim të çdo viti akademik, AU harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe programi i studimit MP në "Shkenca Penale", veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe elementeve të tjerë, pjesë e jetës universitare.</p> <p>Ky raport miratohet nga senati akademik i AU, dhe gjithashtu i dërgohet MASR.</p>
--	--

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma</p>	<p>AU ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve që ofron. Kështu, AU është vlerësuar pozitivisht në akreditimin e fundit institucional, duke kaluar pozitivisht akreditimin me kohëzgjatje 2 vjeçare, shprehur kjo me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017.</p> <p>AU ka një organizim strukturor të brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë, si dhe ka</p>
---	---

formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përmbushje të standardeve të kërkuara.

AU ka përdorur rregullisht një sërë mekanizmash formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e këtij programi studimi.

Aktualisht ky sistem i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga Komisioni i Vlerësimit Institucional dhe NJSBC (Evidenca 2.1 dhe Evidenca 1.3). Ky sistem, përbëhet nga Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni për Vlerësimin Institucional është organ kolegjal prej 5 anëtarësh i ngritur me vendim të Senatit Akademik të AU-së, në përbërje të të cilit është edhe një student i zgjedhur nga këshilli studentor. Në varësi të këtij Komisioni funksionon NJSBC e cila realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. NJSBC harton një raport vjetor ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Komisionit për Vlerësimin Institucional dhe më pas i kalon Senatit Akademik të AU-së (Evidenca 1.3, neni 14). Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional organizohet nga NJSBC si rregull një herë në 3 vjet. (Evidenca 2.1, neni 67/7), por nëse është e nevojshme, NJSBC mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh.

Për sigurimin e cilësisë, AU ka ngritur strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel departamenti, që merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur, gjithmonë në përputhje me Manualin për "Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit". Në vitin 2016, me Vendim të Senatit Akademik të AU-së u vendos ngritja e grupeve të brendshme të sigurimit të cilësisë deri në nivel departamenti (Evidenca 6.1). Në Departamentin e Shkencave Juridike, 2 nga anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të këtij departamenti, gjithashtu janë pjesë e grupit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo konsiderohet nga GVJ si një praktikë e mirë që duhet konsoliduar në vijim.

NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm të institucionit e strukturave të tij, e që më pas nxjerr raportet me gjetjet përkatëse. NJSBC për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga studentët e programit. GVB ka autonomi në punën e tij dhe akses në të dhëna institucionale për efekt vlerësimi (Evidenca 2.1, neni 67).

Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit akademik, nëpërmjet të dhënave të raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve që bëhen në fund të çdo semestri, para zhvillimit të provimeve përfundimtare, për një vlerësim sa më objektiv dhe të paanshëm nga studentët. Po ashtu një praktikë e mirë e evidentuar është organizimi i fokus-grupeve që realizohen një herë në vit me studentët (Evidenca 3.8) si dhe një pyetësor i ri që është futur së fundmi në këtë proces, për t'u plotësuar nga pedagogët. Këto të dhëna të vlerësimit që pasqyrohen në raportin vjetor të NJSBC-së, publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit të AU-së (Evidenca 2.1, neni 67).

GVJ konsideron se duhen bërë përpjekje për përfshirje më të madhe të studentëve por edhe të pedagogëve në plotësimin e pyetësorëve, gjë që do të ndihmonte në marrjen e feedback-ut më të plotë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.

Siç doli edhe nga vizita në institucion, syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik, me pjesëmarrjen e grupit të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, apo botime të reja në fushë, raste praktike/kazuse, etj. në lidhje me rritjen e cilësisë dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës (Evidenca 6.2). Përgjegjësi i departamentit ndjek rregullisht dhe sistematikisht zbatimin e programeve të studimeve nga pedagogët, dhe vlerëson programet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës.

Institucioni, në fillim të çdo viti akademik, në javët orientuese informon studentët mbi programet e ofruara dhe rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit, avantazhet që nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit si dhe

vlerësimi institucional (Shih edhe Evidencën 7.3).

Institucioni ka bërë përpjekje në vazhdimësi për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të AU-së, tashmë edhe e publikuar në faqen web të institucionit (Evidenca 1.4)

Konkluzionet e vlerësimit:

Në AU, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është një sistem tashmë i konsoliduar institucional që është ngritur dhe funksionon që prej vitit akademik 2009-2010.

Ky sistem, aktualisht përbëhet nga Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni për Vlerësimin Institucional është organ kolegjal prej 5 anëtarësh i ngritur me vendim të Senatit Akademik të AU-së, në përbërje të të cilit është edhe një student i zgjedhur nga këshilli studentor. Në varësi të këtij Komisioni funksionon NJSBC e cila realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë.

Theksi është vënë në forcimin e rolit dhe përgjegjësisë së departamentit në proceset akademike dhe përmirësimin e cilësisë si në aktivitetin akademik ashtu edhe atë kërkimor-shkencor. Në vitin 2016, me Vendim të Senatit Akademik të AU-së u vendos ngritja e grupeve të brendshme të sigurimit të cilësisë deri në nivel departamenti. Në Departamentin e Shkencave Juridike, 2 nga anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të këtij departamenti, gjithashtu janë pjesë e grupit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo konsiderohet nga GVJ si një praktikë e mirë që duhet konsoliduar në vijim.

Duhet bërë përpjekje për përfshirje më të madhe të studentëve por edhe të pedagogëve në plotësimin e pyetësorëve, gjë që do të ndihmonte në marrjen e feedback-ut me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.

NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm të institucionit e strukturave të tij, e që më pas nxjerr raportet me gjetjet përkatëse. NJSBC për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga studentët e programit.

GVJ rekomandon që për një vlerësim sa më objektiv por dhe kritik të cilësisë së programit të studimit, departamenti të angazhonte edhe një ekspert të jashtëm.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2012-2013. Në gjashtë vite të funksionimit të tij janë diplomuar 95 studentë dhe ka angazhuar në procesin e mësimdhënies 20 pedagogë. Kohëzgjatja e këtij programi studimi është 1 vit akademik, dhe përbëhet nga 60 kredite (ECTS) gjithsej, kjo pas riorganizimit të tij në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislatiioni për arsimin e lartë në fuqi.

Ky program studimi i ciklit të dytë ka si objektiv të formojë studentët me njohuri specifike në fushën e së drejtës penale. Programi kombinon formimin akademik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme kryesisht në fushën e drejtësisë, por jo vetëm (p.sh. prokurori apo gjykata të niveleve të ndryshme të sistemit gjyqësor) dhe me studio ligjore prestigjioze, vendase dhe të huaja, pranë të cilave mund të zhvillohen edhe praktika profesionale. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në

verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar

Studentët që ndjekin këtë program studimi do të kenë mundësi të punësohen apo të vijnë në karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e shkencave penale. Ky program i ofron mundësi studentëve të cilët duan të punojnë në administratën publike, fushën e avokatisë, si juristë pranë institucione, konsulentë ligjorë pranë autoriteteve të pavarura etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit MP në "Shkenca penale" është licensuar me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009, mbështetur me Urdhërin Nr. 308, datë 08.06.2010 dhe akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 585, datë 27.11.2012 (Evidenca H.6). Në përfundim të programit të studimit MP "Shkenca penale", studenti pajiset me Diplomën përkatëse, që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor;
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor;
- 1 ECTS baraz me 25 orë mësimore pune të studentit;
- Ora mësimore është 50 minuta.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë jepet në tabelën 10 të anekseve.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (tabela 13 e anekseve):

- Leksionet 240 orë në auditor dhe 260 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 120 orë në auditor dhe 280 orë punë e pavarur e studentit
- Ushtrime 120 orë në auditor dhe 80 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikat lëndore ___ orë në auditor dhe ___ orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 120 orë në auditor dhe 30 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 12 orë në auditor dhe 138 orë punë e pavarur e studentit

Komponentët mësimorë ndahen në orë mësimi në auditor, si leksione, seminare/ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh dhe përgatitje për provime apo përgatitjen e tezës së diplomës; dhe praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private (Tabela 14.1 dhe 14.2 e anekseve).

Kjo ndarje e orëve mësimore në auditor, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit MP "Shkenca penale", në bazë të krediteve që ka secila lënda (Evidenca 1.1.A). Duke filluar nga viti akademik 2018-2019, ndarja në kredite dhe përqindja që zënë lëndët në këtë program studimi, është bërë sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Departamenti ka zgjedhur si formë të përfundimit të studimeve mbrojtjen me temë diplome para komisionit të ngritur për këtë qëllim. Tema e diplomës ka karakter teoriko aplikativ dhe studentit drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij. Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi (Evidenca 1.1.A, Kreu V).

Siç u përmend edhe më sipër, në vitin akademik 2017-2018, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e

Shqipërisë”, janë rishikuar planet mësimore si dhe janë riorganizuar programet e studimit Master, ku përfshihet edhe MP “Shkenca Penale” e cila kaloi nga nga 90 në 60 ECTS (Evidenca 3.4). Në tabelën 11 të anekseve të raportit, jepen edhe ndryshimet në planin mësimor MP “Shkenca penale”.

Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për lëndën përkatëse të këtij programi studimi, si: emërtimi dhe kreditet e lëndës, titullari dhe/ose lektori (kur këta janë të ndryshëm) dhe asistenti nëse lënda ka të tillë, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar (Evidenca 4.4).

Në fillim të vitit akademik studentët njihen përmes broshurës informuese, ndër të tjera, edhe me programin e studimit që ndjekin, përmbajtjen e tij dhe të lëndëve që ofrohen (Evidenca 7.3). Në fillim të semestrit, studentëve iu vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ndjekin. Këto programe pas miratimit u vihen në dispozicion studentëve, si dhe bëhen publike. Departamenti organizon edhe aktivitetin e tutoriatit/këshillimit akademik për studentët, sipas një kalendari të caktuar paraprakisht, në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet e brendshme të AU-së (Evidenca 2.6, neni 23).

Në përditësimin e syllabuseve, merr rëndësi propozimi që mund të vijë nga pedagogu i lëndës si dhe mendimi studentor. Departamenti bashkëpunon me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës për përmirësime të programit të studimit dhe përmbajtjes së tij dhe komponentëve që e përbëjnë apo për ndryshime të mundshme (Evidenca 1.3, neni 16) dhe me grupin e vlerësimit të cilësisë në nivel departamenti për përmirësimin e syllabuseve të lëndëve dhe materialit që vihet në dispozicion të studentit (Evidenca 2.6, neni 12).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programet që ofron Departamenti i Shkencave Juridike janë të akredituara (Evidenca H.6), përfshirë edhe programin MP “Shkenca penale”. Ky program studimi referuar LAL dhe akteve të brendshme rregullatore të institucionit, organizohet në module/lëndë dhe vlerësohen në kredite ECTS (Evidenca 1.1.A). Këto kredite ndahen mes 5 disiplinave kryesore që përbëjnë strukturën e këtij programi (Evidenca 1.1.A, neni 6), mbi bazën e VKM-së së sipërpërmendur (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”)</p> <p>Prej vitit akademik 2018-2019, ky program studimi përshtatet dhe bëhet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në përmbushje të detyrimeve ligjore.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i</p>	<p>Në MP “Shkenca penale” regjistrohen studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor. Ky program studimi i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara teorike dhe praktike në fushën e së drejtës penale.</p> <p>Objektivat e këtij programi janë të qartë, të ndërtuar mbi bazën e objektivave institucionalë (Evidenca</p>

Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

1.1.A). Ky program studimi ndiqet nga studentët që kanë një diplomë të nivelit Bachelor në drejtësi. Përmes këtij programi, ata pajisen me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e së drejtës penale, që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fsuëhn e së drejtës penale, dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Hartimi i këtij programi studimi është bërë duke marrë parasysh faktin që përmbajtja e objektivave të tij të jetë në përputhje me qëllimin e programit me kriteret dhe detyrimet për këtë program, si program i ofruar në nivelin master profesional, sipas përcaktimeve ligjore dhe të akteve të brendshme rregullatore të AU-së.

Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë dhe/apo shkrim.

Vlerësimi final i referohet disa elementëve: vlerësimit përfundimtar, provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar, aktivizimit gjatë seminareve dhe ushtrimeve, si dhe detyrave të kursit, me pikëzimin e mëposhtëm:

- Provimi përfundimtar 60 pikë
- Provimi i ndërmjetëm 20 pikë
- Pjesëmarrja aktive në seminare 10 pikë
- Ese/prezantim/pune në grup 10 pikë

(Evidenca 1.1 dhe Evidenca 1.1.A).

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Programi i studimit MP “Shkenca penale” është hartuar në përputhje me strategjinë e AU-së, vizionin dhe misionin e saj, nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar në drejtme të caktuara në fushën e së drejtës, misionin e arsimit të lartë në vend dhe objektivat e procesit të Bolonjës, dhe përpiqet të përfshijë në mënyrën më të mirë të integruar, modelet dhe përvojën europiane bashkëkohore.

Për hartimin e tij është mbajtur parasysh gjithashtu eksperiencia e mëparshme e këtij institucioni, kuadri rregullator në fuqi, nevojat e tregut të punës dhe praktikën e njohura europiane, me qëllim njohjen ndërkombëtare të diplomës, për të afirmuar traditën dhe vlerat e arsimit të lartë shqiptar (Evidenca 1.1.A). Për hartimin e këtij programi studimi sipas kriterëve/kërkesave ligjore, janë marrë për model disa programe të universiteteve të njohura europiane, me qëllim që studentët të kenë mundësi të konkurrojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendas, por edhe atij rajonal/europian (Evidenca 1.2).

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arrijtjen e qëllimeve të tij.

Në këtë program studimi, studenti merr njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e së drejtës penale, duke iu përshtatur gjithnjë e më shumë nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit (Evidenca 1.1.A).

Programi i studimit MP “Shkenca penale” është një program i ciklit të dytë të studimeve, i ndërtuar në përputhje me strategjinë 5 vjeçare për zhvillim të AU-së.

Mbi këtë strategji institucionale, Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar strategjinë e tij afatshkurtër për vitin akademik 2018-2019 (Evidenca 1.2).

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka kualifikimin përkatës në fushën e së drejtës penale dhe vijon të jetë i angazhuar në këtë fushë në punën e tij kërkimore dhe shkencore. Kjo i shërben avancimit akademik të stafit, kualifikimit dhe trajnimit të mëtejshëm në fushë dhe transmetimit më të mirë të dijeve dhe performancë më të lartë në auditor. Kjo realizohet përmes pjesëmarrjes dhe referimeve në konferenca, seminare, trajnime, publikime të ndryshme, që shërbejnë në cilësinë dhe synimet e programit (për aktivizimin e personelit akademik në veprimtari shkencore shih edhe tabelën 19 të anekseve).

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Përmes analizave/studimit të tregut të punës, departamenti synon që ta përshtasë sa më mirë këtë program të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet institucionale në këtë drejtim (Evidenca 7.2). Do të duhet që studime të tilla të analizohen dhe diskutohen në nivel departamenti apo edhe më tej, me qëllim nxjerrjen dhe analizën e problemeve në funksion të përmirësimit të cilësisë që ofrohet për këtë program.</p> <p>Përmes këtij programi, synohet të formohen juristë të specializuar në drejtme të caktuara të së drejtës penale, me qëllim që të jenë konkurrentë të denjë në tregun e punës dhe të plotësojnë nevojat për specialistë në këtë fushë të së drejtës (Evidenca 1.1.A).</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Në hartimin dhe përditësimin e programit të studimit MP “Shkenca penale”, departamenti i shkencave juridike ka marrë parasysh nevojat e tregut për përgatitjen e profesionistëve në fushën e së drejtës penale, si dhe të ndihmojë brezin e studentëve të përmbushin aspiratat e tyre për zhvillim.</p> <p>Departamenti i shkencave juridike ka realizuar një analizë të tregut të punës (Evidenca 7.2)</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe me interesat e vlerat kombëtare, duke synuar formimin e profesionistëve në fushën e shkencave penale (Evidenca 1.1.A, neni 4).</p> <p>Ky program synon të arsimojë dhe trajnojë profesionalisht studentët në fushën e së drejtës penale si dhe synon të krijojë tek ta aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në “Shkenca penale” realizohet me 90 ECTS dhe zgjaste 1.5 vite akademike (Evidenca 1.1).</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, ky program do të</p>

akademike.	realizohet me 60 ECTS në përputhje me LAL dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik (Evidenca 1.1.A).
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Plani mësimor për këtë program studimi u bëhet me dije të interesuarve përmes mjeteve dhe burimeve të ndryshme të informimit. Ai mund të gjendet në informacionin që u jepet të interesuarve në fillim të vitit akademik përmes materialeve, posteave, broshurave informuese, etj (Evidenca 7.3) si dhe mund të aksesohet edhe në rrugë elektronike në faqen web të institucionit:</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/broshura-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve/ dhe https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/.</p> <p>Aktualisht ka një strukturë për informimin dhe këshillimin e studentëve, që lehtëon dhënien e këtij informacioni.</p> <p>Departamenti në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit, jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. (Evidenca 1.1.A). Syllabuset janë të vlefshme për studentët në hard copy por edhe elektronikisht</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master Profesional” janë parashikuar kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Plani i diplomimit shpjegohet në mënyrë të detajuar në manualin e studentit dhe ai prezantohet në fillim të vitit. Në të jepet edhe informacioni i duhur në lidhje me diplomimin në përfundim të këtij programi studimi si dhe orientohen studentët në lidhje me kriteret që duhet të përmbajë një punim diplome i këtij cikli studimi (Evidenca 3.9).</p> <p>Me ndryshimet në planin aktual dhe kalimin nga 90 në 60 ECTS, teza e diplomës vlerësohet me 6 ECTS dhe është në përputhje me kriteret e vendosura nga aktet nënligjore në fuqi. (Evidenca 3.4).</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca penale” është hartuar në përputhje me misionin, objektivat dhe Strategjinë për Zhvillimin e AU-së.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe respekton traditën, interesat dhe vlerat kombëtare.</p> <p>Ky program synon arsimimin dhe formimin e profesionistëve në fushën e së drejtës penale si dhe synon të krijojë tek ta aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale.</p> <p>Programi i studimit bazohet, merr parasysh zhvillimet në fushën e arsimit të lartë dhe nevojat e tregut të punës, me qëllim që studentët të kenë mundësi punësimi pas përfundimit të studimeve në këtë program.</p> <p>Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai synon ruajtjen dhe promovimin e vlerave dhe interesave kombëtare.</p>	

Kohëzgjatja e programit të studimit dhe përfitimi i krediteve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AU u ofron studentëve informacionin e duhur dhe të nevojshëm, përfshirë edhe planin/mënyrën e diplomimit, si pjesë e detyrimeve përmblylëse për përfundimin e këtij programi dhe marrjen e diplomës përkatëse. Ky informacion jepet nëpërmjet mjeteve të ndryshme, si në hard copy ashtu edhe përmes web site të universitetit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Lëndët organizohen në formën e orëve mësimore si: leksione, seminare, ushtrime, prezantime detyrë/projekt kursi, praktikë profesionale. Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit). Kreditet e një lënde fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese (Evidenca 1.1.A).

Zhvillimi i orës mësimore synon interaktivitetin dhe të menduarit kritik të studentit. Për specifikat e programit, rëndësi marrin ushtrimet dhe trajtimet e rasteve studimore të ndryshme, në varësi edhe të specifikave të çdo lënde në këtë program studimi. Azhornimi me praktikën gjyqësore dhe jursiprudencën vendase apo europiane është me interes për studentët dhe nga syllabuset e shqyrtuara si dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët, duket se në këtë program studimi i jepet rëndësia e duhur.

Çdo lëndë e këtij programi ka syllabusin e saj (Evidenca 4.4). Ato përditësohen vazhdimisht mbi bazën e nevojave dhe zhvillimeve në fushën e së drejtës, mbi bazën e propozimeve të lektorit/titullarit të lëndës dhe në bashkëpunim me grupin e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti (Evidenca 2.6), për t'ia përcjellë më pas strukturave të tjera sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme.

Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është dinamik dhe përbëhet nga disa komponentë. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimave me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikave mësimore dhe gjyqeve simuluese si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit MP "Shkenca penale" (Evidenca 1.1.A dhe Evidenca 2.6). Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmblylës në këtë cikël studimi, institucioni ka përgatitur edhe një manual për punimin e temës së diplomës (Evidenca 3.9).

Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave e të kompetencave profesionale të programit MP nga studenti.

Vlerësimi i treguesve të matshëm

Zhvillimi i procesit mësimor realizohet nga ekspertë të fushës por dhe nga pedagogë të rinj, nga pedagogë që kanë tituj dhe grada, por edhe profesionistë të drejtësisë me eksperiencë profesionale. Leksionet zhvillohen duke përdorur mjete teknologjike për prezantimin viziv (videoprojektor, flipchart, etj).

Format e kontrollit të njohurive

Përsa i përket kontrollit të njohurive, shkalla e përvetësimit të dijeve/vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me shkronja nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese (Evidenca 1.1. dhe 1.1.A).

Në AU vlen parimi i kontrollit të vazhdueshëm të njohurive, sipas të cilit studenti vlerësohet sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 10% të vlerës së pikëve totale dhe 10 % detyra e kursit, testi i pjesshëm ka 20% të vlerës së pikëve totale dhe provimi përfundimtar ka vlerën 60% të vlerës së pikëve totale (shih tabelën 15 të anekseve).

Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur (Evidenca 1.1.A dhe Evidenca 2.6).

Pjesë e detyrueshme e veprimtarisë formuese të programit dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet, është dhe praktika mësimore. Praktika përfshin orë në auditor (2 orë/javë) dhe orët praktike në institucion, nën mbikëqyrjen e një pedagogu të caktuar nga përgjegjësi i departamentit për këtë qëllim. Në përfundim të praktikës studenti duhet të paraqesë dosjen përkatëse. Eksperiencë e mirë është organizimi në fund të praktikës i seancave/gjyqit simulues, për të parë dhe vlerësuar në mënyrë simuluese aftësitë teorike të fituara, nivelin e analizës dhe mendimit kritik nga ana e studentëve. Vlerësimi i studentit për praktikën mësimore bëhet me notë. Studenti i cili nuk shlyen praktikën mësimore nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën (Evidenca 1.1.A).

Aktivizimi i studentëve të këtij programi në komponentët e aktivitetit të departamentit/fakultetit

Studentët janë pjesë e rëndësishme aktive e gjithë aktivitetit akademik, mësimor të Departamentit/Fakultetit. Ata përmes pyetësorëve apo fokus-grupeve japin mendimin e tyre për procesin akademik, lëndët, pedagogët dhe performancën e tyre si dhe stafin administrativ dhe shërbimet mbështetëse për ta, duke kontribuar kështu në cilësinë e programit të studimit (Evidenca 3.8 dhe Evidenca 6.2).

Studentët janë aktivizuar gjithashtu edhe në aktivitete të organizuara nga Departamenti/Fakulteti si psh. Konferenca (i.e. konferenca studentore), leksione të hapura, trajnime me tema të ndryshme me interes për studentët etj. duke dhënë asistencën/kontributin e tyre në këto aktivitete. Po ashtu, leksionet e hapura me lektorë të njohur të ftuar në auditor, me pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve shtetërore, profesionistë të njohur të fushës, i shërbejnë zgjerimit të njohurive të tyre dhe forcimit të lidhjes mes aspekteve teorike dhe atyre praktike në formimin e tyre profesional (Evidenca 6.2 dhe Evidenca 10.1). Forcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit institucional me subjekte/organizata/institucione të tjera kryesisht vendase, është një mundësi e mirë për studentët e këtij programi studimi, për praktikimin e dijeve dhe për internship-e apo stazhe të ndryshme. Gjithashtu, në AU funksionon edhe “Klubi i juristëve të rinj” si një strukturë e krijuar nga studentët e Departamentit të Shkencave Juridike.

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se studentët janë aktivizuar në disa aktivitete të organizuara nga departamenti/fakulteti, si më poshtë (Tabela 16 e anekseve):

- Për punime shkencore individuale të pedagogëve janë aktivizuar 8 studentë;
- Për projekte në nivel departamenti janë aktivizuar 3 studentë dhe
- Për projekte në rang fakulteti janë aktivizuar 2 studentë

AU ka adoptuar një politikë të vetën, për reduktimin e tarifave të studimit për grupe të caktuara studentësh apo për akordimin edhe të bursave të plota. Veçanërisht rëndësi i kushtohet studentëve ekselentë, studentëve në nevojë, me status të veçantë familjar apo social, etj. Studentët me rezultatet akademike më të larta motivohen brenda sistemit për t'u angazhuar dhe/ose punësuar më pas në aktivitete apo struktura brenda universitetit. Kjo konsiderohet nga GVJ si një praktikë e mirë që duhet forcuar për motivimin e studentëve.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në “Shkenca penale”, studenti duhet të ketë një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në fushën juridike prej 180 ECTS. Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë kriteret hyrëse të vendosura nga AU (Evidenca 1.1.A). Kohëzgjatja normale e programit të studimit MP “Shkenca Penale” prej 90 ECTS ishte 1.5 vite akademike dhe afati maksimal i përfundimit të këtij program ishte 3 vite akademike (Evidenca 1.1).

Kohëzgjatja normale e programit të studimit MP "Shkenca penale" (pas riorganizimit me 60 ECTS) duke filluar nga viti akademik 2018-2019 është 1 vit akademik dhe maksimalja 2 vite akademike për mbylljen e studimeve në këtë program (Evidenca 1.1.A).

Nëpërmjet politikave, kritereve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultate sa më të larta.

Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar duke dorëzuar dosjen përkatëse sipas kritereve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Pas një vlerësimi formal të listës së dokumenteve të nevojshme, ato i kalohen Departamentit të Shkencave Juridike, i cili kryen një vlerësim të kushteve të çdo kandidati me kriteret akademike e shkencore të programit (Evidenca 1.1.A, neni 10). Departamenti shpall listën e kandidatëve fitues për programet master me renditjen përkatëse përpara fillimit të procesit mësimor. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH dhe aktet e brendshme rregullatore të AU-së.

Në fillim të çdo viti akademik, ata studentë që vendosin të vazhdojnë studimet pranë AU "Albanian University" mund të transferojnë studimet nga një universitet tjetër publik ose privat. Bazuar në Rregulloren e transferimeve të institucionit, fillimisht studenti i interesuar depoziton dosjen me të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Kjo dosje vlerësohet nga komisioni i ekuivalentimit dhe transferimeve, i ngritur në çdo fakultet. Në përfundim të shqyrtimit të dosjes, merret një vendim nga komisioni i ekuivalentimeve dhe transferimeve që ngrihet nga dekani i fakultetit, vendim i cili i bëhet i ditur studentit. Rregulla më të hollësishme për transferimet parashikohen në Rregulloren e Transferimeve (Evidenca 3.5 neni 29 dhe Evidenca 1.1.A, neni 13).

Strukturat e tjera që funksionojnë në mbështetje të veprimtarisë akademike dhe aktiviteteve (psh. Zyra e Karrierës dhe Alumni, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët), sekretaria mësimore dhe departamenti kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij.

Sekretaria mësimore përpilon regjistrat, të cilët janë specifik për çdo lëndë dhe grup. Regjistri i grupit është një dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimit nga pedagogu. Ai është dokument zyrtar gjithashtu që vërteton frekuentimin e orës së mësimit nga studenti dhe evidenton kreditet që ai ka siguruar në atë lëndë si dhe zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës (Evidenca 3,5, neni 33). Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat në përfundim depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Ndarja e studentëve në grupe shënohet në regjistra me fillimin e vitit akademik. Detyrimi i studentëve për frekuentim është jo më pak se 75% e orëve mësimore. Në rast se studenti ka kryer më tepër se 25 % të mungesave të orëve mësimore në lëndë ai nuk mund të hyjë në provimin e parë të lëndës (Evidenca 1.1.A, neni 15).

Vlerësimi i treguesve të matshëm

Në programin e studimit MP "Shkenca penale" rezulton se për periudhën 2012-2018, numri total i të diplomuarve është 95, nga të cilët numri i të punësuarve në përputhje me diplomën është 48 dhe numri i atyre të punësuar jo në përputhje me diplomën është 20 (27 studentë nuk ka qenë e mundur të kontaktohen) (shih tabela 18 e anekseve).

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve për këtë program studimi pasqyrohet në tabelën 17 në anekset e këtij raporti. Cilësia në hyrje e studentëve është e ndryshme, në varësi të IAL-së ku kanë përfunduar studimet Bachelor dhe të përparimit personal të tyre.

Numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite pothuajse nuk ka luhatje të mëdha. Por ka raste që studentët kalojnë në vitet pasardhëse me lëndë të pashlyera. Rregullorja lejon vazhdimin e studimeve në kursin pasardhës kur studenti ka fituar nota kaluese në lëndë me mbi 30 kredite në një vit akademik (mbi 50%).

Kritere specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi nuk ka. Studentët e regjistruar dhe që kanë ndjekur ndër vite kanë program studimi sipas të dhënave të marra nga sekretaria mësimore (shih tabelën 17 të anekseve), paraqiten si më poshtë:

Në vitin akademik 2012-2013 janë rregjistruar për herë të parë 32 studentë (në vit të parë) me notë mesatare hyrëse 6.89; nga të cilët 21 janë diplomuar dhe 11 të padiplomuar;
 Në vitin akademik 2013-2014 nuk ka studentë të rregjistruar;
 Në vitin akademik 2014-2015 janë rregjistruar 48 studentë ku për herë të parë 34 studentë (në vit të parë) dhe 14 studentë të ardhur me transferim në vit të parë, me notë mesatare hyrëse 6.85, nga të cilët 38 janë diplomuar dhe 9 të padiplomuar, 1 student i ç'rregjistruar;
 Në vitin akademik 2015-2016 janë rregjistruar për herë të parë 15 studentë nga të cilët 13 për herë të parë në vit të parë, 2 studente të rregjistruar me transferim në vit të dytë me notë mesatare 6.53; nga të cilët 12 janë diplomuar dhe 3 të padiplomuar;
 Në vitin akademik 2016-2017 janë rregjistruar për herë të parë 19 studentë (në vit të parë) dhe 1 student i regjistruar me transferim në vit të parë me notë mesatare 6.56, nga të cilët 8 janë diplomuar dhe 12 të padiplomuar;
 Në vitin akademik 2017-2018 janë rregjistruar gjithsej 33 studentë ku 1 studente e regjistruar si program të dytë studimi në vit të parë, me notë mesatare hyrëse 6.57.
 Në vitin akademik 2018-2019 janë rregjistruar 11 studentë për herë të parë me mesatare hyrëse 6.28.

Promovimi dhe nxitja e studentëve më të mirë është një politikë e Albanian University, duke akorduar bursa (të plota apo të pjesshme-reduktim tarife) për kategori të tilla, si: studentët e ekselencës; por gjithashtu AU akordon edhe bursa të ndërmjetme apo bursa për kategori sociale të caktuara, si: për studentët në nevojë, jetimët, fëmijët e policëve të vrarë, etj. (Evidenca 2.1, nenet 77-78 dhe Evidenca 1.3, neni 56).
 Këta studentë përfitojnë nga Programi i Ekselencës dhe i Bursave sipas kritereve të vendosura nga institucioni për këtë qëllim.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në</p>	<p>Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në "Shkenca penale", studentit duhet të ketë marrë një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në përputhje me fushën e studimit. Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve bachelor në përputhje me fushën e studimit ku ka grumbulluar 180 kredite ECTS; 2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë; 3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore. <p>Në rast se studentit ka marrë një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart atëherë Komisioni i njohjes dhe ekuivalentimit të programeve i ngritur nga departamenti i shkencave juridike, vlerëson aplikimin duke pasur në konsideratë këto kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dosjen e kandidatit - Motivimin e tij për të ndjekur programin e studimit të kërkuar. <p>(Evidenca 1.1.A, nenet 10-11).</p> <p>Për programet e studimeve "Master Profesional",</p>

përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.

siç përcaktohet edhe nga Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, studentët e këtyre programeve studimi duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare (Evidenca 3.5, neni 25/4). Në rregulloret e brendshme nuk parashikohet shprehimisht cili është niveli i njohjes së kësaj gjuhe nga studentët e pranuar në këtë program studimi të ciklit të dytë, por ai mund të jetë B1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve, nëse do të ruhet si kriter pranimi për këtë program studimi nga AU. Nëse jo, atëherë sugjerojmë që të bëhet ndryshim në nenin 25/4 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, duke e specifikuar si kriter vetëm për MSH (Master i Shkencave).

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e II-të të studimeve, MP "Shkenca penale", sipas kritereve të caktuara nga institucioni, i nënshtrohet vlerësimeve për ndryshime të mundshme në kriteret e pranimit, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në Shqipëri dhe aktet e brendshme rregullatore të AU-së (Evidenca 1.1.A).

Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.

Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtij programi studimi, përmes sesioneve informuese, nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, apo përmes organizimit të Panairit të Karrierës, etj.

AU ka strukturat e tij për pritjen e studentëve dhe pranimin e tyre në çdo fillim viti akademik, për informimin mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, mundësitë për transferime kreditesh, etj. (Evidenca 1.1.A). Gjithashtu, studentët marrin informacion edhe për mundësitë e ndryshme të punësimit pas përfundimit të studimeve në këtë program.

Studentëve u jepet ky informacion nëpërmjet takimeve të organizuara nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. Kështu, në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij organizohen 'orët e hapura' ku studentët njohën më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj.


	<p>Për këtë qëllim, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin (Evidenca 7.3). Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manual i Studentit.</p> <p>Një rol me rëndësi në këtë drejtim ka Zyra e Karrierës dhe Alumni, që siguron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët (Evidenca 1.1.A, neni 11). Gjithashtu, kjo zyrë mban lidhjet me alumni, si dhe shërben si urë lidhëse për studentët, me universitetin dhe tregun e punës. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. Ky këshillim konsiston në asistencën që u jepet studentëve për çështje të tilla si p.sh. si të shkruhet një CV, prezantimi në një intervistë, etika në komunikim, etj. AU ka hartuar për këtë qëllim për studentët edhe “Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës” (Evidenca 9.1).</p>
--	---

Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>AU disponon statistika mbi numrin e të regjistruarve, transferuarve dhe të larguarve nga programet e ciklit të dytë, numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që ofron, si dhe të dhëna mbi ecurinë e studentëve, që nga pranimi deri në diplomim (Shih tabelën 17 dhe 18 të anekseve).</p> <p>Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të ndryshme që hartohen si në nivel njësie (Evidenca 6.2) ashtu edhe në raportin vjetor institucional, si dhe janë pjesë e raportimeve institucionale.</p>
---	--

Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>AU disponon të dhëna në lidhje me studentët e punësuar pas përfundimit të programeve të studimit si dhe pozicionet e punësimit të tyre në vende pune të ndryshme, të dhëna këto që mbahen nga Zyra e Karrierës dhe Alumni. Kështu p.sh. në programin e studimit MP “Shkenca Penale” në periudhën 2012-2018 janë diplomuar gjithsesj 105 studentë, nga të cilët 57 të punësuar në përputhje me diplomën e marrë, 23 të punësuar jo në profilin sipas diplomës së marrë dhe 20 të tjerë</p>
--	--



	<p>nuk ka qenë e mundur të kontaktohen (Tabela 18 e anekseve).</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të parë mundësinë e ndjekjes së studimeve të mëtejshme në cikle të tjera, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin.</p>
--	--

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera informon studentët mbi programin e studimit MP "Shkenca penale", përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve etj. (shih p.sh.Evidenca 7.1).

Studenti ka të drejtë të informohet me programin mësimor dhe përmbajtjen e tij, lëndët/modulet që zhvillohen, syllabuset e tyre, pranë sekretarisë mësimore apo zyrës së informacionit; njihet me detyrimet semstrale dhe vjetore përmes plan programit mësimor apo vendimeve të nxjerra nga departamenti apo senati (Evidenca 1.1.A, neni 26).

Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët (Evidenca 3.5, neni 38 dhe Evidenca 1.1.A, neni 24).

Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar.

Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit, pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe ka të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (Evidenca 1.1.A, neni 23).

Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Përmes departamentit, studentëve të këtij program studimi u ofrohet këshillim dhe kudestari (tutoriat) gjatë gjithë periudhës së studimeve (Evidenca 1.1. A).

Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetje dhe konsultim që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me temën e diplomës që mbron studentin në përfundim të këtij cikli dhe parametrat që ajo duhet të plotësojë. (Evidenca 3.9).

Në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, Departamenti orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin do të zhvillojnë praktikën mësimore.

Praktikat mësimore zhvillohen në institucionet, subjektet apo organizatat me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi, nën mbikëqyrjen e një pedagogu të caktuar nga departamenti i shkencave juridike (Evidenca 11.1 dhe Evidenca 1.1.A, neni 27).

Gjithashtu, departamenti i informon studentët për mënyrën e zhvillimit të praktikës mësimore, detyrimeve që kanë, dosjen që duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në përfundim të periudhës së praktikës për efekt vlerësimi me notë dhe kredite. Departamenti i Shkencave Juridike ka krijuar një traditë të mirë për organizimin e seancave/gjyqeve simuluese si pjesë e orëve të parashikuara për praktikën mësimore dhe vlerësimin e studentëve për këtë qëllim.

Konkluzionet e vlerësimit:

Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në “Shkenca penale”, studentin duhet të ketë një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në fushën juridike prej 180 ECTS. Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë kriteret hyrëse të vendosura nga AU në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Kohëzgjatja normale e programit të studimit MP “Shkenca penale” (pas riorganizimit me 60 ECTS) duke filluar nga viti akademik 2018-2019 është 1 vit akademik dhe maksimalja 2 vite akademike për mbylljen e studimeve në këtë program.

Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me njësi/struktura të informon studentët mbi programin e studimit MP “Shkenca Penale”, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve etj.

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master.

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manualin e Studentit.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban dhe përditëson statistikën mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit MP "Shkenca Penale" si dhe harton një bazë të dhënash mbi pozicionet e punësimit të tyre në vende pune të ndryshme, si dhe mban kontakte me këta studentë dhe shërben si urë lidhëse mes universitetit, studentëve, rregull të punës.

Praktika mësimore përmban orë në auditor dhe orë praktike në institucionin, subjektin apo organizatën me të cilën institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi e ku do të zhvillohet praktika. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin do të zhvillojnë praktikën mësimore.

Departamenti i Shkencave Juridike ka krijuar një traditë të mirë për organizimin e seancave/gjyqeve simuluese si pjesë e orëve të parashikuara për praktikën mësimore dhe vlerësimin e studentëve për këtë qëllim.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor në përputhje me strategjinë dhe misionin e AU-së, me interesat e universitetit, të stafit akademik dhe studentor, si dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe financiare.

Kërkimi shkencor kryesisht bazohet në këto parametra: Revista shkencore "Optime" që botohet nga universiteti (Evidenca 4.5), Konferencat shkencore (ku një është e përvitshme), si dhe aktivitete të tjera që synojnë forcimin e kërkimit shkencor apo dhe aktivitete ekstrakurikulare (Evidenca 6.2). Gjithashtu, në ndihmë të këtij procesi është edhe biblioteka universitare si dhe bibliotekat online që u mundësohen pa pagesë stafit akademik dhe studentëve të institucionit, për të garantuar aksesin në këtë literaturë.


Po ashtu, Departamenti i Shkencave Juridike ka bashkëpunim të ngushtë dhe me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Ndër të tjera, kjo zyrë duhet të bashkërendojë punën me departamentin për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe duhet të kontribuojë në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare (Evidenca 1.3). Megjithatë, pavarësisht disa aplikimeve, deri tani nuk ka ndonjë projekt të fituar (Evidenca 6.2, fq.58-59; shih dhe tabelën 19 të anekseve të këtij raporti). Nga të dhënat gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se janë bërë disa aplikime nga ana e departamentit të shkencave juridike, ku disa kanë marrë përgjigje negative, ndërsa për disa të tjera ende pritet përgjigje. Revista shkencore "Optime" botohet nga AU dhe synon t'i japë në rradhë të parë mundësi stafit të institucionit për të botuar, por edhe studiuesve të tjerë nga institucione të tjera. Qëllimi i kësaj reviste është nxitja e debatit shkencor si dhe publikimi/promovimi i punës shkencore të stafit akademik. Ajo dallohet për dinamikën dhe llojshmërinë e rubrikave që gjejnë pasqyrim në të (Evidenca 4.5).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Çdo vit organizohet një konferencë shkencore, me tematika aktuale që përfshijnë disa disiplina, ku përfshihen edhe shkencat juridike. Siç u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion, personelit akademik efektiv i mundësohet një reduktim i fee-së (pagesës) së pjesëmarrjes dhe kontributit në këtë konferencë dhe si i tillë u përmend një rast i një pedagoge që kishte bërë kërkesë për këtë qëllim dhe kjo ishte aprovuar. Referimet në konferencë botohen si punime të konferencës. Në mjaft raste, konferenca vjetore organizohet në bashkëpunim me universitete të tjera vendase apo dhe të huaja. (Evidenca 6.2).

Po ashtu, edhe publikimet e stafit akademik efektiv në revistën 'Optime' janë pa pagesë, si pjesë e politikës së institucionit.

Gjithashtu, në lidhje me kërkimin shkencor institucioni mbështet promovimin e stafit akademik efektiv për avancimin në kualifikimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen në aktivitete shkencore jashtë



vendit. Por kjo nuk shoqërohet edhe me mbështetje financiare. Pavarësisht se gjatë takimeve me stafin akademik efektiv të departamentit u përmend se ekziston mundësia që kundrejt një procedure kërkese për mbështetje financiare, kjo të mundësohej, por aktualisht nuk kishte një praktikë apo rast konkret ku stafi akademik efektiv të ishte mbështetur financiarisht nga institucioni në aktivitete shkencore jashtë vendit apo për kërkim shkencor jashtë vendit.

Në këtë drejtim, përfshirja e pedagogëve në aktivitete shkencore/projekte të kërkimit shkencor ka qenë mbi baza individuale, fokusuar në: avancimin e tyre akademik për marrjen e gradës shkencore 'Doktor', botime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, konferenca shkencore kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe për përgatitjen e teksteve bazë për përmirësimin e cilësisë në këtë program studimi (Evidenca 6.2).

Në lidhje me botimet e ndryshme nga institucioni, përveç revistës "Optime", një mundësi tjetër ofrohet edhe për botimet që bëhen nga AU Press, e që pasurojnë botimet në fusha të ndryshme sipas programeve që ofrohen.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv i departamentit të shkencave juridike publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse, ku kryesore është revista e AU-së "Optime" e indeksuar me numër ISSN (Evidenca 4.5) si dhe në revista të tjera vendase apo ndërkombëtare. Qëllimi është nxitja e debatit shkencor si dhe publikimi e promovimi i punës shkencore të stafit akademik.</p> <p>Këto veprimtari shkencore mundësojnë promovimin e stafit akademik për të avancuar me grada shkencore dhe tituj akademikë, si dhe rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe veprimtari shkencore (Evidenca 6.2).</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Departamenti i shkencave juridike e ofron programin MP "Shkenca penale" në gjuhën shqipe dhe nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj (Evidenca 2.1, neni 59/1).</p> <p>Në çdo rast, në departament disa pedagogë, të cilët kanë mbaruar studimet jashtë vendit, mund të mbulojnë mësimdhënien në gjuhë të huaj (Evidenca H.7).</p> <p>GVJ mendon se mundësia për ofrimin e temave/leksioneve të caktuara në gjuhë të huaj (anglisht) do të ishte e këshillueshme të aplikohet, si një praktikë e dobishme për studentët e ciklit të dytë të studimeve MP.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p>	<p>Institucioni momentalisht nuk ofron, por ka në fokus të rrisë rolin e tij për mundësi për kualifikime të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit, për personelin akademik mësimor-</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimitor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>shkencor nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme apo bashkëpunimeve të ndryshme institucionale.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon të dhënat mbi studimet shkencore, botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit dhe projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Aktualisht, kjo përfshirje në aktivitet/projekt kërkimor-shkencor është mbi baza individuale nga stafi akademik efektiv i departamentit. Personali akademik i departamentit si ai me kohë të plotë ashtu edhe ai me kohë të pjesshme, për çdo vit akademik plotëson me vetëdeklarim formularin tip në lidhje me vlerësimin e stafit akademik në fushën akademike e kërkimore-shkencore, ku ndër të tjera paraqiten konferencat shkencore ku pedagogu ka marrë pjesë, botimet e ndryshme që mund të ketë bërë ose të planifikuara, pjesëmarrje në projekte, programe mobiliteti, ai anëtarë të revista shkencore me bord editorial, etj (Evidenca 10.2). Kjo bazë të dhënash përditësohet çdo vit akademik dhe disponohet si nga departamenti ashtu edhe nga Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Botimeve (Evidenca 6.2). Në lidhje me të dhënat individuale për bashkëpunimin ndërkombëtar në vite, shih tabelën 20 të anekseve si dhe Evidencën 6.2.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Personeli akademik i departamentit të shkencave juridike angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në nivel institucional apo në bashkëpunim me institucione të tjera, mbi baza individuale nga ana e stafit akademik efektiv të departamentit. Personeli akademik publikon artikuj në revista shkencore, punime të referuara në konferenca shkencore, në profilin/disiplinën përkatëse të interesit, ku më kryesorja është revista “Optime” e botuar nga AU. Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari kontribuon në avancimin e tij akademik, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin shkencor. Institucioni mbështet kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit akademik të tij, por aktualisht nuk organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Aktualisht, departamenti i shkencave juridike e ofron programin MP “Shkenca penale” vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj. Departamenti i Shkencave Juridike disponon të dhëna të përditësuara në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij (artikuj, referime në konferenca, tekste, etj.) brenda e jashtë vendit. Në të ardhmen, institucioni duhet të angazhohet më tepër në krijimin e mundësive dhe mbështetje financiare që duhet t’i japë stafit akademik për kualifikimin e mëtejshëm të tij dhe pjesëmarrje në veprimtari shkencore e kërkimore, veçanërisht jashtë vendit.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

AU ka bërë përpjekje për të krijuar ura bashkëpunimi me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat, organizata profesionale, me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Institucioni organizon në fillim të vitit akademik disa ditë informimi ku janë shpërndarë broshura informuese si udhëzues programesh, plan programe dhe materiale të tjera me interes (Evidenca 7.3).

AU ka bashkëpunim të ngushtë me IAL të tjera vendase ku përmendim marrëveshjet e bashkëpunimit me: Universitetin e Tiranës, Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Universitetin "Fan Noli" Korçë, Bashkinë e Tiranës, qendrën sociale "Të qëndrojmë së bashku", etj.

Ndërsa në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera të huaja, përmendim: me Universitetin e Aquila-s në Itali, me Universitetin S. Freud të Vjenës, me Universitetin e Padova Itali, ISPE-Kolegji Prishtinë, etj.

Nga të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se AU ka 15 marrëveshje bashkëpunimi aktive. Këto marrëveshje janë institucionale, por në këtë numër përfshihen edhe ato që janë me interes për njësinë bazë/kryesore dhe programet e studimit që mbulon.

Gjithashtu, departamenti ka lidhur 14 marrëveshje me institucione, organizata dhe subjekte publike apo private me qëllim bashkëpunimi apo edhe për zhvillimin e praktikave mësimore (Evidenca 11.1).

AU ka bërë përpjekje për të ndërtuar ura lidhëse me tregun e punës për një lidhje më të madhe mes programit të studimit MP "Shkenca Penale" me tregun e punës. Për këtë qëllim, është realizuar edhe një studim për tregun e punës dhe nevojat e tij (Evidenca 7.2).

Gjithashtu, AU merr pjesë edhe në Panairin e Karrierës që organizohet një herë në vit në muajin qershor, me pjesëmarrje të mjaft subjekteve të interesuar për bashkëpunim me këtë IAL.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar jepen në anekset e këtij raporti (tabela 20 dhe 21 e Anekseve).

Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi dhe marrëveshjet institucionale që ka Departamenti i Shkencave Juridike me institucione vendase për zhvillimin e praktikave profesionale në kuadër të detyrimeve akademike sipas programit të studimit MP "Shkenca Penale" (Evidenca 11.1) si dhe për internship-e për studentët. Në lidhje me këtë të fundit përmenden 2 internship-e të zhvilluara: me Bashkinë e Tiranës dhe Shoqatën Kombëtare të Jetimëve, ku studentët e këtij departamenti janë përfshirë aktivisht. Konkretisht për studentët e MP "Shkenca penale", vlen të theksohet internship-i pranë Bashkisë Tiranë, në një iniciativë kundër bulizmit në shkollat e Tiranës, ku 4 prej studentëve të këtij programi studimi morën pjesë në këtë iniciativë e cila kap periudhën shtator 2018-mars 2019, të dhëna këto të marra nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Po ashtu, me riorganizimin strukturor të njësive/strukturave të AU-së, në vitin 2016 u krijuan dy zyra të veçanta: Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon edhe për gjurmimin e studentëve në tregun e punës si dhe mbajtjen e lidhjeve mes tyre dhe universitetit. Zhvillimi i karrierës përshkruan procesin e vazhdueshëm të një personi i cili menaxhon jetën, mësimin dhe punën gjatë jetës. Informacion më të detajuar për këtë qëllim jepen në Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës të përgatitur nga kjo zyrë (Evidenca 9.1).

Me fillimin e vitit akademik, gjatë javës së parë të tij, organizohet *Open days*, ku Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët vë në dispozicion manualin orientues për studentët me të drejtat, detyrat e tyre, organizimin institucional, programin e studimit, ambientet, stafin akademik dhe ndihmës-akademik dhe administrativ përkatës, etj. (Evidenca 7.3).

Po ashtu, organizohen edhe leksione të hapura, sipas një kalendari të përcaktuar, ku ftohen studiues apo profesionistë të ndryshëm për tema të caktuara. Këto leksione të hapura ndiqen edhe nga studentët e MP “Shkenca Penale”, në orare të përshtatshme, pa penguar zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithashtu, organizohen dhe aktivitete dhe veprimtari ekstrakurrikulare të ndryshme, si: konferenca, trajnime, ëorkshop-e etj (Evidenca 10.1), por edhe aktivitete të tjera social-kulturore si: aktivitete sportive, teatrore, kulturore, etj. Nga informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, rezultoi se së fundmi, është ngritur edhe një grup teatrore ku nga MP “Shkenca penale” merr pjesë një student. Po ashtu në institucion funksionon edhe një klub studentor i quajtur “Klubi i juristëve të rinj”.

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët në bashkëpunim me departamentin, u vë në dispozicion studentëve informacionin mbi kalendarin e aktiviteteve ekstrakurrikulare në çdo fillim viti.

Nga të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se gjatë periudhës 2017-2019 janë realizuar mbi bazë kalendari dhe në bashkëpunim me departamentin rreth 70 aktivitete të tilla.

Në kuadër të thirrjeve për projekte kërkimore, nga takimet në institucion, rezultoi se janë bërë disa aplikime, ku disa janë nuk janë fituar, ndërsa për disa të tjera pritet përgjigje.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Për kryerjen e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programit të studimeve MP “Shkenca penale”, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me subjekte të ndryshme nga fusha e biznesit apo sektori publik, si: marrëveshje bashkëpunimi me studio ligjore/zyra avokatie, Institucione të Administratës Shtetërore (ministri), institucione të drejtësisë (gjykata, prokurori), OJF, etj. (Evidenca 11.1).</p> <p>Këto bashkëpunime ofrojnë mundësi të mira për studentët e këtij programi për t’u njohur me praktikën e institucioneve shtetërore apo subjekteve private, për të gërshetuar aspektin teorik me atë praktik që merr rëndësi për profesionin e juristit. (Evidenca 11.1). Disa nga këto marrëveshje bashkëpunimi vlejné edhe për realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare të studentëve të këtij programi apo edhe për internship-e të caktuara.</p> <p>Për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, Departamenti i Shkencave Juridike ka realizuar edhe një analizë të tregut të punës për programin e studimit MP “Shkenca penale” viti akademik 2018-2019 (Evidenca 7.2). GVJ e vlerëson këtë si tregues pozitiv të departamentit të shkencave juridike. Nga takimet me stafin akademik gjatë vizitës në institucion (efektiv apo me kohë të pjesshme), rezultoi se pak ose aspak ishin të informuar për realizimin e studimeve/analizave të tilla të tregut të punës nga ana e departamentit dhe përmbajtjes/gjetjeve të</p>

	<p>tyre. Kështu që, sugjerojmë se këto analiza dhe studime duhet të njihen nga gjithë personeli akademik i departamentit, t'u bëhen me dije dhe të diskutohen apo analizohen edhe në mbledhje departamenti, për të qenë në koherencë me problemet e evidentuara dhe nevojat që shtrohen.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni synon dhe promovon bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet anëtarëve të personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit si dhe bashkëpunimit mes strukturave për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Po ashtu, jo vetëm në nivel njësie bazë, por edhe në nivele të tjera, AU ka synim të rrisë bashkëpunimin mes njësisë bazë/kryesore në aktivitete apo projekte me interes të përbashkët si dhe të fuqizojë dhe konsolidojë bashkëpunimin mes strukturave dhe njësisë përbërëse për realizimin e proceseve akademike dhe kërkimore apo edhe aktiviteteve akademike apo ekstrakurikulare me interes për studentët (Evidenca 6.2 dhe Evidenca 10.1).</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU për realizimin e objektivave të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendas (Evidenca 1.2).</p> <p>Më konkretisht, AU ka 15 marrëveshje bashkëpunimi aktive me institucione brenda dhe jashtë vendit, ku përmendim marrëveshjet me disa universitete si: Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Universiteti i Tiranës etj, apo disa universitete dhe kolegje universitare në Kosovë, Itali, Turqi, etj. si dhe 14 marrëveshje bashkëpunimi dhe për zhvillimin e praktikave mësimore me institucione, subjekte publike apo private vendase (Evidenca 11.1).</p> <p>Disa prej këtyre marrëveshjeve shërbejnë edhe për mundësimin e realizimit të praktikave profesionale në bashkërendim me institucionet apo subjektet ku realizohen këto praktika, në përmbushje të detyrimeve akademike që ka ky program studimi (praktika profesionale në këtë program studimi vlerësohet me 6 ECTS).</p> <p>Ky program studimi synon të formojë juristë të specializuar me aftësi profesionale në fushën e të drejtës penale dhe shkencave penale në tërësi, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave aktuale dhe perspektivave të tregut të punës.</p> <p>Lind nevoja që këto marrëveshje të shtohen si</p>

dhe të zbatohen më mirë praktikisht apo edhe të rishikohen (veçanërisht ato me institucione ndërkombëtare) për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të programit të studimit, rritjes së shkëmbimeve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve, aktiviteteve të përbashkëta që mund të organizohen me interes për studentët e këtij programi studimi.

Veçanërisht me vlerë do të ishte rritja e bashkëpunimit me institucione akademike jashtë vendit, për të forcuar këtë bashkëpunim dhe për të mundësuar rritjen e lidhjeve me institucione ndërkombëtare akademike apo të kërkimit shkencor.

Një vlerësim analitik më i plotë i këtyre marrëveshjeve dhe dobisë së tyre apo zbatimit praktik, duhet të merret në konsideratë në vijim.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstaton se institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas kryerjen e praktikave të studentëve të tij. Kështu, Departamenti i Shkencave Juridike aktualisht ka nënshkruar dhe zbaton 14 marrëveshje bashkëpunimi dhe për zhvillimin e praktikave mësimore me institucione, subjekte publike apo private vendase.

Po ashtu, departamenti ka realizuar edhe një studim për tregun e punës (viti akademik 2018-2019). Sugjerojmë se analiza/studime të tregut të punës të bëra nga ana e departamentit të shkencave juridike, duhet të njihen nga gjithë personeli akademik i departamentit, t'u bëhen me dije dhe të diskutohen apo analizohen edhe në mbledhje departamenti apo takime të veçanta, për të qenë në koherencë me problemet e evidentuara dhe nevojat që shtrohen si dhe përmirësime të mundshme.

Institucioni synon dhe promovon bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet anëtarëve të personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit si dhe bashkëpunimit mes strukturave/njësisve për realizimin e programit të studimit dhe aktivitete të tjera në mbështetje të procesit mësimor-kërkimor.

Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. AU disponon një numër jo të vogël marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL vendase apo të huaja, ku 13 prej tyre mund të aplikohen edhe për Departamentin e Shkencave Juridike të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, por këto marrëveshje duhet të shtohen si dhe të zbatohen më mirë praktikisht, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë.

Veçanërisht me vlerë do të ishte rritja e bashkëpunimit me institucione akademike jashtë vendit, rajonale apo të vendeve të Bashkimit Europian, për të forcuar këtë bashkëpunim dhe për të mundësuar rritjen e lidhjeve me institucione ndërkombëtare akademike apo të kërkimit shkencor. Kjo do të forconte dhe rriste cilësinë e aktivitetit akademik dhe kërkimor si dhe do të ishte një mundësi e mirë për rritjen e shkëmbimeve dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA AKREDITIMI I PARË

I.1. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

1. Biblioteka të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës.
2. Të rritet numri i personelit akademik me eksperiencë akademike të huaj për të rritur brenda auditorit procesin e të menduarit kritik.
3. Të krijohet lidhje më të mira me tregun e punës dhe statistika për të patur njohje me atë çfarë tregu i punës ofron.
4. Kërkimi shkencor duhet të jëtë në një nivel të atillë që të jetë sa i më i krahasueshëm me nivelin europian.
5. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

I.2. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. Për rekomandimin “*Biblioteka të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës*”, rezulton se në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Shkencave Juridike, funksionon një sallë biblioteke për të plotësuar nevojat e studentëve gjatë ndjekjes së programit të studimit MP “Shkenca penale”, duke shërbyer njëkohësisht edhe si sallë studimi. Biblioteka ka të skeduar 172 tituj tekste mësimore, artistike dhe revista të ndryshme. Pjesë e bibliotekës janë edhe bibliotekat online si Questia, ERIC, etj. Ambienti i bibliotekës i siguron studentëve një mjedis të qetë për të studiuar, por të kufizuar në një kapacitet prej 26 vendesh. Po ashtu, duhet bërë një sistemim më i mirë i fondit të bibliotekës si dhe shtimi i titujve me literaturë të huaj. Gjithashtu mendojmë se duhet të shihet mundësia që aksesin në bibliotekë dhe fondin e saj të vijojë për studentët e nivelit master, edhe pas orës 16:00, për të krijuar më shumë komoditet për studentët e këtij programi. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.

2. Për rekomandimin “*Të rritet numri i personelit akademik me eksperiencë akademike të huaj për të rritur brenda auditorit procesin e të menduarit kritik*”, stafi akademik që rekrutohet synohet të ketë kualifikimet e nevojshme akademike, ku preferohen persona me tituj e grada shkencore, profesionistë të njohur të fushës dhe me eksperiencë profesionale, apo të rinj që janë shkolluar në universitetet e huaja, si p.sh. Itali, Bullgari. Kjo me qëllim që të garantohet një shërbim cilësor bashkëkohor ndaj studentëve të këtij programi. Në rradhët e këtij stafi Departamenti i Shkencave Juridike ka angazhuar edhe staf akademik të kualifikuar/specializuar në Shqipëri por që mund të kenë kryer trajnime jashtë vendit. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar.

3. Për rekomandimin “*Të krijohet lidhje më të mira me tregun e punës dhe statistika për të patur njohje me atë çfarë tregu i punës ofron*”, Departamenti i Shkencave Juridike ka kryer tashmë një studim të tregut të punës. Gjithashtu ai ka dhe 14 marrëveshje bashkëpunimi me institucione/organizata dhe subjekte private vendase, të cilat krijojnë mundësi për bashkëpunimin institucional dhe lidhje më të mira me tregun e punës si dhe për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve, apo edhe për kryerjen e intershipeve. Mbështetje në mbarëvajtjen e procesit jep edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit duke siguruar komunikimin e duhur me institucionet e mundshme për të zhvilluar praktikën si dhe për internship-e të ndryshme. Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të parë mundësinë e ndjekjes së studimeve të mëtejshme në cikle të tjera, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Kjo zyrë mban dhe përditëson

statistikat mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit MP “Shkenca Penale” si dhe harton një bazë të dhënash mbi pozicionet e punësimit të tyre në vende pune të ndryshme, si dhe mban kontakte me këta studentë dhe shërben si urë lidhëse mes universitetit, studentëve, tregut të punës. Nga ana tjetër Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, ndihmon studentët qoftë me orientimet për të aplikuar për një vend pune po ashtu edhe duke i mbajtur gjithmonë në kontakt për mundësitë e reja që dalin për punësim. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar.

4. Për rekomandimin “*Kërkimi shkencor duhet të jetë në një nivel të atillë që të jetë sa më i krahasueshëm me nivelin evropian*”, Departamenti i Shkencave Juridike ka bashkëpunim të ngushtë dhe me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Në këtë aspekt theksohet realizimi i përvitshëm i një konference shkencore ndërkombëtare, ku personeli akademik me kohë të plotë përjashtohet nga detyrimi për pagimin e fee së konferencës. Po ashtu, ky staf motivohet të publikojë artikuj shkencorë në revistën e AU-së “Optime”, pa pagesë, sipas fushave të interesit. Departamenti duhet ndër të tjera, të bashkërendojë punën me këtë zyrë për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe duhet të kontribuojë në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare Megjithatë, pavarësisht disa aplikimeve, deri tani nuk ka ndonjë projekt të fituar. Janë bërë disa aplikime për projekte nga ana e Departamentit të Shkencave Juridike, ku disa kanë marrë përgjigje negative, ndërsa për disa të tjera ende pritet përgjigje. Nga sa konstatohet, kjo nuk është e mjaftueshme për një kërkim cilësor të standardeve evropiane dhe duhen bërë më shumë përpjekje për rritjen e bashkëpunimit me institucione vendase apo të huaja në këtë drejtim si dhe të aplikimit për projekte të ndryshme evropiane apo ndërkombëtare me interes dhe impakt në fushën juridike. GVJ mendon se ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.

5. Për rekomandimin “*Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare*”, institucioni shprehet se në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional nuk parashikohet një detyrim i tillë si në fazën e regjistrimit ashtu edhe në atë të diplomimit.

Ligji Nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri*”, në nenin 75/6 përcakton se programet e studimeve “Master Profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar, por ky ligj nuk bën përcaktim për njohjen e gjuhës së huaj si kriter pranimit për këtë program studimi (ndryshe nga sa përcakton shprehimisht për Masterin e Shkencave në nenin 76/4 të tij). Në zbatim të këtij ligji, Udhëzimi i MASR Nr. 52, datë 03.12.2015 “*Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë*”, i ndryshuar, përcakton në pikën 3 të tij se *për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit.*

Në nenin 76/1 ligji përcakton se *pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.*

Në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në nenin 25/4 me titull “Programet e studimit të ciklit të dytë: përcaktohet se “*Studentët e këtyre programeve studimi duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare*”, pa bërë dallimin mes tyre, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe programet e studimit master profesional.

Për sa më sipër, ndonëse gjuha e huaj nuk është më kriter detyrues për MP, ajo që do t'i sugjerohej AU-së, është që të përcaktohet në rregulloren e brendshme të programit të studimit niveli B1 i njohjes së gjuhës së huaj, si kriter hyrës, nëse ky do të ruhet si kriter pranimit në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, edhe për programet e studimit MP që ky fakultet ofron.

AU është një qendër e autorizuar për testimin e gjuhës angleze Toeic, L&R, APTIS dhe Cambridge, gjë që ofron dhe komoditet për studentët, duke qenë se stafi administrativ informon dhe lehtëson për ta procesin e regjistrimit, si dhe tërheqjen e certifikatave në këtë institucion.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES -MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)

a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit MP "Shkenca penale" ka për synim aftësimin e studentëve të formuar jo vetëm nga pikëpamja teorike por edhe ajo praktike me qëllim orientimin e tyre sa më të mirë në tregun e punës.
2. Ky program studimi ndikon pozitivisht në plotësimin e nevojave të tregut të punës me juristë të specializuar në fushën e së drejtës private. Ai ndikon gjithashtu pozitivisht në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.
3. Procedura e rekrutimit të stafit është transparente dhe synon përthithjen e stafëve të kualifikuar, mbi bazën e konkurrencës të hapur dhe shpallje publike.
4. Stafi akademik që rekrutohet synohet të ketë kualifikimet e nevojshme akademike, ku preferohen persona me tituj e grada shkencore, profesionistë të njohur të fushës dhe me eksperiencë profesionale, të rinj që janë shkolluar në universitetet perëndimore. Kjo me qëllim që të garantohet një shërbim cilësor bashkëkohor ndaj studentëve të këtij programi.
5. Në përshtatje me dinamikën e ndryshimeve dhe zhvillimeve në arsimin e lartë, syllabuset janë të ndërtuara sipas parametrave të kërkuar ligjorë dhe të përshtatshme për këtë program studimi e lëndët që përmban ai. Përditësimi i syllabuseve dhe pasurimi i tyre, për të reflektuar ndryshimet dhe zhvillimet pozitive në fushën juridike.
6. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor në pajisje dhe mjete didaktike dhe audiovizuale për të bërë sa më të kuptueshëm dhe tërheqëse orën mësimore.
7. Aksesit në biblioteka online mjaft të pasura me tituj dhe materiale që ofrojnë (i.e Questia), për të gjithë stafin akademik dhe studentët e universitetit, pa pagesë, gjatë 24 orëve.
8. Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm dhe sa më objektiv të studentit si dhe për të garantuar transparencën në vlerësim. Kjo mënyrë vlerësimi ka dhe natyrë stimuluese.
9. Sigurimi i brendshëm i cilësisë, si një nga komponentët që është përmirësuar dhe konsoliduar në vijimësi. Sigurimi i brendshëm i cilësisë përmes NJSBC-së dhe njësisë së sigurimit të cilësisë në nivel departamenti është një hap pozitiv dhe një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë akademike, i cili synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore në lidhje me cilësinë e programit të studimit.
10. Përpjekja nga ana e institucionit për sa më shumë përfshirje të studentëve në procesin mësimor dhe jashtë tij, përmes një sërë aktiviteteve dhe veprimtarish akademike, shkencore dhe ekstrakurikulare që organizohen gjatë vitit akademik.
11. Tërheqja e mendimit të studentëve për programin, përmbajtjen e tij dhe për performancën e stafit, me anë të pyetësorëve apo dhe fokus-grupeve i ka shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.
12. Politika favorizuese dhe motivuese e tarifave të reduktuara/bursave për kategori të ndryshme studentësh si: studentët ekselentë, studentë që i përkasin kategorive të personave në nevojë, etj.
13. Bashkëpunim institucional i konsoliduar për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe mundësi për internship-e.
14. Institucioni ka stabilitet financiar gjë që krijon premisa për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij.

b. Pika të dobëta:

1. Mosrespektimi i kriterit të kërkuar ligjor në lidhje me raportin min. 70 % PAE dhe 30 % PAK.
2. Mundësi të kufizuara për mundësi apo mbështetjen financiare në lidhje me kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik e kërkimor. Institucioni duhet të rrisë rolin e tij për mundësi për kërkimin shkencor dhe kualifikime të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit, për personelin akademik me kohë të plotë, nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme apo bashkëpunimeve të ndryshme institucionale. Kjo do të rriste gjithashtu edhe mundësinë për mobilitetin e stafit dhe studentëve të interesuar.
3. Mungon financimi dhe mbështetja e iniciativave, projekteve kërkimore apo zhvillimore të stafit akademik si dhe shërbimeve/konsulencave që mund të ofrohen, me përfitim për institucionin dhe personelin akademik.
4. Mungesa e interesit për përfshirje nga ana e një numri studentësh të MP "E drejtë private" në aktivitetin akademik dhe veprimtarinë shkencore të departamentit apo edhe në aktivitete ekstrakurikulare, apo pamundësia për të marrë pjesë në këto aktivitete për shkak të punësimit të tyre gjatë kohës së studimit.
5. Probleme në salla të caktuara për zhvillimin e mësimin për studentët e këtij programi, për shkak të mosfunksionimit të duhur të sistemit të ngrohjes/ftohjes.
6. Hapësira të kufizuara fizike për të shfrytëzuar bibliotekën e fakultetit (me një kapacitet fizik prej 26 vendesh). Po ashtu, duhet parë mundësia që për studentët e programit master, orari të mund të zgjatet pas orës 16.00 gjatë ditëve të javës.

c. Mundësitë:

1. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun. Proceset integruese dhe reformat në të cilat është përfshirë vendi ynë, (posaçërisht në fushën e integritit evropian dhe të reformës në drejtësi) krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit të AU-së me institucione të tjera rajonale apo dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor si dhe të aplikimit për projekte të ndryshme europiane apo ndërkombëtare me interes dhe impakt në fushën juridike.
2. Marrëveshjet aktuale në fuqi, krijojnë një bazë potenciale për shkëmbim dhe mobilitet, si dhe aktivitete të përbashkëta akademike e kërkimore.
3. Forcimi i rolit të departamentit dhe dhënia e më shumë kompetencave njësisë bazë, krijon më shumë mundësi për aktivitete akademike e mësimore-shkencore brenda dhe jashtë AU-së.
4. Në lidhje me botimet e ndryshme nga institucioni, përveç revistës "Optime", një mundësi tjetër ofrohet edhe nga publikimet e AU Press, e që pasurojnë botimet dhe literaturën për programin e studimit.
5. AU është një qendër e autorizuar për testimin e gjuhës angleze ToEIC, L&R, APTIS dhe Cambridge, gjë që ofron dhe komoditet për studentët e programeve master, në informimin mbi procesin e regjistrimit, si dhe tërheqjen e certifikatave në këtë institucion.

d. Pengesat:

1. Ndryshimet në legjislacionin për arsimin e lartë dhe dalja e akteve të reja nënligjore (ose dhe vonesa në nxjerrjen e tyre), sjell nevojën për të bërë ndryshime apo përshtatje të këtij programi studimi dhe vështirësi në vlerësimin e output-it real të tij. Po ashtu, edhe probleme të caktuara që mund të dalin në lidhje me zbatimin e LAL-së apo konstituimin e agjensive/organeve shtetërore të caktuara në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
2. Moskonsolidimi në nivelin e duhur i tregut të punës.
3. Mosnjohja në nivelin e duhur e gjuhës së huaj (kryesisht anglisht) nga studentët e këtij programi, është kufizim për aksesimin e literaturës që ofrohet nga biblioteka fizike apo online.


Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që AU të rekrutojë stafin akademik të nevojshëm, me qëllim që të plotësohet kriteri për të pasur në këtë program studimi min. 70 % PAE.
2. Duhet parë mundësia që për studentët e programit master, orari i bibliotekës të mund të zgjatet pas orës 16.00 gjatë ditëve të javës.
3. GVJ sugjeron që të shihet mundësia që, në të ardhmen, Institucioni të ketë një përcaktim të ngarkesës vjetore në orë mësimore (në auditor), në rregulloret e brendshme, në mënyrë që të krijohet hapësirë për më shumë veprimtari kërkimore e shkencore nga PAE; si dhe të mund të përcaktohet një raport ndërmjet veprimtarive të ndryshme ku anagazhohet personeli akademik me kohë të plotë (neni 59 pika 2 dhe 7, dhe neni 95 i ligjit 80/2015); për t'i dhënë më shumë hapësirë ndërkombëtarizimit të stafit, aplikimit në projekte veçanërisht ndërkombëtare, etj. si dhe orientimit të stafit në raport me veprimtarinë mësimore apo kërkimore të zhvilluar (shih edhe Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR).
4. GVJ rekomandon që për një vlerësim sa më objektiv por dhe kritik të cilësisë së programit të studimit, departamenti të angazhojë edhe një ekspert të jashtëm për këtë qëllim.
5. GVJ sugjeron se analiza/studime të tregut të punës të bëra nga ana e departamentit të shkencave juridike, duhet të njihen nga gjithë personeli akademik i departamentit, t'u bëhen me dije dhe të diskutohen apo analizohen edhe në mbledhje departamenti apo takime të veçanta, për të qenë në koherencë me problemet e evidentuara dhe nevojat që shtrohen si dhe për të bërë përmirësime të mundshme në këtë program studimi.
6. Marrëveshje të reja bashkëpunimi me IAL vendase apo të huaja duhet të shtohen dhe të jenë prioritet për institucionin, si dhe të zbatohen më mirë praktikisht marrëveshjet ekzistuese, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë të së drejtës, si dhe për të zgjeruar/forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar.
7. GVJ rekomandon që Institucioni duhet të rrisë rolin e tij në ofrimin e mundësive të mëtejshme dhe mbështetje financiare për kërkime dhe kualifikime, qoftë brenda apo jashtë vendit, për stafin akademik me kohë të plotë, përmes aplikimit në projekte të ndryshme ose forcimit të bashkëpunimeve institucionale. Kjo gjithashtu do të rriste mundësinë për mobilitetin e stafit dhe studentëve të interesuar.
8. Veçanërisht me vlerë do të ishte rritja e bashkëpunimit me institucione akademike jashtë vendit, rajonale apo të vendeve të Bashkimit Europian, për të forcuar këtë bashkëpunim dhe për të mundësuar rritjen e lidhjeve me institucione ndërkombëtare akademike apo të kërkimit shkencor. Kjo do të forconte dhe rriste cilësinë e aktivitetit akademik dhe kërkimor si dhe do të ishte një mundësi e mirë për rritjen e shkëmbimeve dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER - SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

a. Strengths:

1. The PM Study Program in "Criminal sciences" aims to educate students both from the theoretical and practical point of view in order to enable them a better orientation to the labor market.
2. This study program positively affects the fulfillment of labor market demands for specialized lawyers in the field of private law. It also positively influences the preservation of national cultural values and national interests.
3. The staff recruitment procedure is transparent and aims at hiring qualified staff on the basis of an open competition and public announcement.
4. The academic staff is recruited based on necessary academic qualifications, with a preference of staff with scientific titles and grades, well-known professionals as well as young people educated in western universities. This is to ensure a quality service to students of this program.



5. In line with the dynamics of changes and developments in higher education, syllabi are prepared according to the required legal parameters and appropriate for this study program as well as the subjects it contains. The syllabi update is made to reflect changes and developments in the legal field.
6. The available teaching infrastructure contains both didactic and audiovisual equipment and tools to make the teaching process as interesting and attractive as possible.
7. Access to online libraries rich in titles and materials (i.e. Questia), for all academic staff and students, is available free of charge, during 24 hours.
8. Evaluation of the students is a comprehensive one and the principle of continuous assessment of knowledge applies. Grades/the final score is the result of the combination of several elements calculated based on the overall performance of the student. This method of assessment is stimulating and guarantee transparency in the assessment process, too.
9. Internal quality assurance, is one of the components that has been continuously improved and consolidated. The internal quality assurance provided through the IQAU (Internal Quality Assurance Unit) and the departmental quality assurance unit at the departmental level is a positive step forward and an important aspect of the academic activity that aims at achieving contemporary objectives and standards regarding the quality of the study program.
10. Attempts by the Institution for as much involvement of students as possible in various activities, through a series of academic, scientific and extracurricular activities that are organized during the academic year.
11. Getting the students' opinion on the program, its content and staff performance through questionnaires or focus groups, has served to the continuous improvement of the quality of the study program.
12. Motivating policy of reduced fees or scholarships for various categories of students such as: excellent students, students belonging to categories of persons in need, vulnerable groups, etc.
13. Consolidated institutional cooperation, necessary for the development of professional practices and opportunities for internships.
14. The institution has financial stability, which creates the premises to guarantee the future academic and research activity.

b. Weaknesses:

1. Failure to comply with the required legal criteria regarding the min. 70% full time academic staff and 30% part-time academic staff.
2. Limited opportunities for financial support related to the further qualification of research and academic staff. The institution should increase its role in providing further opportunities for research and qualifications either domestically or abroad, for full-time academic staff, through application to various projects or strengthening the institutional collaborations. This would also increase the opportunity for mobility of the staff and interested students.
3. Lack of funding and limited support of initiatives, development or research projects for academic staff as well as services/consultancies that can be provided, benefiting the institution and academic staff.
4. Lack of interest by a number of PM's students of this study program for participating in academic and scientific activity of department or even in extracurricular activities; or impossibility to participate in these activities due to their employment during the study time.
5. Problems in certain classrooms, due to the failure of the proper heating/cooling system.
6. Limited physical spaces at the Library of the Faculty (with a physical capacity of 26 seats). It should also be considered that for students of the master program, the timetable for access to this library be extended after 16.00 p.m. on weekdays.

c. Opportunities:

1. National, international and public relations co-operation. Integration processes and reforms in which our country is involved (especially in the field of European integration and judicial reform) create great opportunities for the extension of AU cooperation with regional or


- European/international institutions in the field of teaching and research as well as applying to various European or international projects of interest and impact in the legal field.
2. The current agreements in force create a potential basis for exchange and mobility, as well as for joint academic and research activities.
 3. Strengthening of the role of department and vesting more powers to this unit according to the legislation on higher education, creates better opportunities for academic and scientific activities within and outside the AU.
 4. With regard to publications issued by AU, in addition to the "Optime" magazine, another opportunity is offered by various publications printed by AU Press, thus enriching the literature for this study program.
 5. AU is an authorized English language testing center for Toeic, L & R, APTIS and Cambridge program, offering convenience for master program students, facilitating information on the registration process, and the withdrawal of certificates at this institution.

d. Threats:

1. Amendments in the legislation on higher education and the issuance of new by-laws (or sometimes delays in their issuance) demand the need to make changes or adjustments to this study program, as well as may be associated with difficulties in assessing its real output. Also, there are certain problems that may arise regarding the implementation of this legislation or the establishment of certain agencies/state organs in the field of higher education and research.
2. Non-consolidation of the labor market at the right level, remains one of the threats.
3. Lack of knowledge of the appropriate level of foreign language (mainly English) by students of this program is a limitation on access to literature provided by physical or on-line libraries.

Recommendations:

1. EEG recommends to AU to recruit academic staff in order to meet the criteria of the min. 70% full time academic staff teaching in this study program.
2. It should also be considered that for students of the master program, the timetable for access to the library of the faculty be extended after 16.00 p.m. on weekdays.
3. The EEG suggests that in the future, the institution should consider to determine in the internal regulations, an annual teaching load (in class) in order to create space for more scientific and research activities to be developed by the full time academic staff; as well as to determine a ratio between different activities where full-time academic staff is involved (Article 59 point 2 and 7, and Article 95 of Law 80/2015), to give more availability for staff internationalization, application to particularly international projects, etc. as well as staff orientation in relation to teaching, academic or research activity (see also Instruction No. 29, dated 10/09/2018 of the MESY).
4. The EEG recommends that to a more objective and critical evaluation of the quality of the study program, the department should also engage an external expert for that purpose.
5. The EEG suggests that labor market analyzes/studies conducted by the Department of Legal Sciences should be made known to all academic staff of the department, discussed or analyzed at a departmental meeting or special meetings, for being in coherence with identified problems and needs in order to make possible improvements in the program.
6. New cooperation agreements with local or foreign HEIs should be a priority of AU and the agreements already in force should be implemented more effectively in order to better respond to labor market demands for skilled specialists in this field of law and to extend the international collaboration and network.
7. EEG recommends the Institution should increase its role in providing further opportunities for research and qualifications either domestically or abroad, for full-time academic staff, through application to various projects or strengthening the institutional collaborations. This would also increase the opportunity for mobility of the staff and interested students.



8. Particularly of interest would be the increase of cooperation with academic institutions abroad, at regional or European Union level, to strengthen this cooperation and to facilitate the enlargement of network with international academic institutions or scientific research. This would strengthen and enhance the quality of academic and research activity and would be a good opportunity to increase exchanges and mobility of academic staff and students.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. **Prof. Dr. Migena Leskoviku**
2. **Prof. Asoc.Dr. Alketa Elezi**

